

**PROCEDURA DI SELEZIONE PER LA COPERTURA DI 56
POSTI NEL PROFILO PROFESSIONALE DI
TRADUTTORE INTERPRETE
AREA FUNZIONALE C, POSIZIONE ECONOMICA C1**

QUESITI PER LA LINGUA ALBANESE

Note per la consultazione:

- A) Per facilitare la consultazione, per ciascun quesito la risposta esatta è indicata con la lettera “A”**
- B) I nomi propri di personaggi storici e letterari, di artisti e di luoghi non albanesi, qualora non ne sia consolidata una forma albanese, sono dati, secondo la norma ortografica della lingua, in trascrizione fonetica. Se questa si differenzia in modo sensibile dalla grafia in lingua originale, se ne dà, tra parentesi, anche quest’ultima**
- C) I titoli di opere letterarie o cinematografiche e le denominazioni di opere d’arte di autori non albanesi, vengono dati preferibilmente in lingua e grafia originale, cui segue, tra parentesi, la traduzione albanese, solo nei casi in questa si sia affermata nell’uso.**

001. Sipas tezës më të akredituar, pararendësit e popullit shqiptar janë

- A) Ilirët
- B) Pelazgët
- C) Dakët
- D) Trakët

002. Në epokën pararomake mbretëria e fisit ilir të Dardanëve shtrihej në trojet që përkojnë me

- A) Rrafshin e Kosovës dhe pak më gjer, në veri
- B) Luginën e mesme të lumit Vardar
- C) Tokat rreth Gjirit të Ambrakisë
- D) Peloponezin

003. Cili nga mbretërit e shteteve ballkanike pararomake nuk është ilir

- A) Perdika II
- B) Agroni
- C) Glaukia
- D) Bardhyli

004. Më 275 p.e. sonë, mbreti i Epirit Pirro u mund përfundimisht nga Romakët në

- A) Benevento
- B) Herakle
- C) Tarent
- D) Tivar

005. Kolonitë më kryesore që Helenët themeluan gjatë bregdetit që tani është shqiptar janë

- A) Epidamni (Dyrrahu), Apolonia dhe Oriku
- B) Epidamni (Dyrrahu), Korkyra dhe Oriku
- C) Apolonia, Butrinti dhe Auloni
- D) Auloni, Saranda dhe Gjirokastra

006. Kur, më 165 p.e. sonë Romakët e pushtuan përfundimisht Ilirinë, mbret i Ilirëve ishte

- A) Genti
- B) Teuta
- C) Bardhyli
- D) Monuni

007. Me ndarjen e Perandorisë Romake në shek. IV, provincat ilire

- A) mbetën nën Perandorinë e Lindjes
- B) u vetëshpallën mbretëri e pavarur aleate me Bizantin
- C) u ndanë midis Romës dhe Bizantit
- D) mbetën nën Perandorinë e Perëndimit

008. Rruga Egnatia, që lidhte bregdetin e Ilirisë së Jugut me Lindjen ishte vazdhimi përtej Adriatikut i rrugës

- A) Apia
- B) Salaria
- C) Aurelia
- D) Popilia

009. Në shekullin V, struktura kishtare e trevave shqiptare përfshinte

- A) 4 mitropoli (kryepeshkopata)
- B) 10 mitropoli (kryepeshkopata)
- C) nuk kishte mitropoli (kryepeshkopata)
- D) 2 mitropoli (kryepeshkopata)

010. Në shekujt VI - X provincat kishtare të Ilirikut vareshin nga

- A) Papa e Romës
- B) provincat veriore nga Roma, ato jugore nga Patriakru i Kostandinopojës
- C) ishin në një gjendje të papërcaktuar
- D) nga Patriarku i Kostantinopojës

011. Më 732, cili perandor i Bizantit i shkëputi peshkopatat e Ilirikut nga jurisdiksioni i Papës së Romës?

- A) Leoni III ikonoklasti
- B) Justiniani
- C) Anastasi
- D) Theodozi

012. Kryeqendra e Principatës së Arbërit (Shek. XII - XIII) ishte:

- A) Kruja
- B) Lezha
- C) Perlati
- D) Durrësi

013. Cili nga Hohenshtaufenët arriti t'i pushtonte trevat shqiptare në fillim të shekulli XIII?

- A) Mandredi
- B) Frederiku II
- C) Henriku IV
- D) Korradi

014. Më 2 mars 1444, Gjergj Kastriot Skënderbeu thirri kuvendin e parë mbarëshqiptar në funksion antiozoman në

- A) Lezhë
- B) Durrës
- C) Krujë
- D) Prishtinë

015. Në betejën e Fushë-Kosovës të vitit 1389, ku Koalicioni ballkanas u mund nga Osmanët, ngeli i varë prijësi osman

- A) Sulltan Murati I

- B) Sulltan Murati i II
- C) Sulltan Mehmeti II
- D) Ali Pasha

016. Kanunet ishin

- A) kode juridike zakonisht të pashkruara që rregullonin jetën dhe marrëdhëniet shoqërore në trevat shqiptare të Ballkanit
- B) marrëveshje midis bajrakëve të ndryshme të Shqipërisë gjatë sundimit osman
- C) marrëveshje midis principatave shqiptare të Mesjetës së vonë dhe Portës së Lartë
- D) norma që rregullonin marrëdhëniet midis princit dhe popullit në principatat shqiptare të shekujve XII-XIV

017. Gjergj Kastriot Skënderbeu vdiq

- A) më 1468, nga malarja
- B) më 1468, në betejë
- C) më 1465, i vrarë nga një ushtarë tradhtar
- D) më 1471, i vrarë nga një armik i futur në shtëpinë e tij

018. Më 1466, Kruja u rrethua për herë të parë nga trupat osmane me në krye

- A) Sulltan Mehmetin II
- B) Ibn Kemalin
- C) Sulltan Muratin II
- D) Sinan Pashën

019. Rrethimi i dytë i Krujës (1476 -1478) nga ana e Osmanëve përfundoi me

- A) rënien e qytetit
- B) firmosjen e një armëpushimi
- C) mundjen e trupave osmane
- D) pezullimim e rrethimit për shkak të vdekjes së Mehmetit II

020. Spahinjtë ishin:

- A) feudalë osmanë që zotëronin një timar
- B) krerë ushtarakë të kohës së Skënderbeut
- C) krerët e qyteteve shqiptare në shekullin XVI
- D) feudalë osmanë kryengritës

021. Bajrakët ishin:

- A) njësi ushtarako-administrative të vetëqeverisura të formuara në Shqipërinë se veriut nën sundimin osman
- B) lidhje timaresh në funksion antiosman
- C) feude osmane në Shqipërinë e mesme
- D) njësi ushtarako-administrative të vetëqeverisura të formuara në Shqipërinë e jugut nën sundimit osman

022. Devshirme-ja ishte

- A) detyrimi i familjeve të krishtera të trevave të sunduara nga Osmanët për t'i dhënë djem Portës së Lartë për repartin e e jenicerëve ose nevoja të tjera
- B) detyrimi i familjeve të krishtera të trevave të sunduara nga Osmanët për t'i derdhur Portës së Lartë 30% të korrieve të vitit
- C) detyrimi i familjeve të krishtera të trevave të sunduara nga Osmanët për të pranuar besimin islam
- D) detyrimi i familjeve islame shqiptare për të mos patur kontakte me familjet të krishtera

023. Urdhëri mistik i Bektashinjve u themelua

- A) nga Haxhi Bektashi ,në Anadulli nga fundi i shek.. XIII
- B) nga Sari Sallteku, në Anadulli nga fundi i shek. XIII
- C) nga Seid Jahja Shirvaniu në Stamboll më 1287
- D) nga Hazhi Bektash Veliu në Shqipëri nga mesi i shekullit XIV

024. Laramanët ishin

- A) katolikët e fshehtë në trevat shqiptare gjatë sundimit osman
- B) katolikët shqiptarë që kishin pranuar fenë islame
- C) të krishterët shqiptarë që refuzuan të pranonin besimin islam
- D) muslymanët shqiptarë që u kthyen në krishtërimin në shekullin XIX

025. Në vitet 1787 dhe 1793 ushtria osmane pësoi dy disfata nga kryengritësit shqiptar të Pashallëkut të Shkodrës të udhëhequr nga

- A) Mahmut Pashë Bushatlliu
- B) Ahmet Kurt Pasha
- C) Mehmet Pashë Bushatlliu
- D) Mehmet Pashë Çausholli

026. Ali Pashë Tepelena u vra më 5 shkurt 1822 në manastirin e Shën Panteleionit, në ishullin e Liqenit të Janinës nga

- A) një i dërguar i Hurshid Pashës
- B) Hurshid Pasha
- C) Omer Pashë Vrioni
- D) Tahir Abazi

027. Reforma ushtarake osmane e viteve 30 të shek. XIX e bëri shërbimin ushtarak

- A) të detyrueshëm dhe pa shpërblim për të gjithë muslymanët
- B) të detyrueshëm dhe me shpërblim për të gjithë shqiptarët
- C) të detyrueshëm dhe pa shpërblim për të gjithë të krishterët në tokat e Perandorisë Osmane
- D) vullnetar.

028. Nizamia ishte

- A) tatimi që në shek. XIX të krishterët shqiptarë paguanin në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm

- B) shërbimi ushtarak që në shek. XIX shqiptarët muslymanë duhej të kryenin detyrimisht në ushtrinë osmane
- C) tatimi që shqiptarët i paguanin Portës së Lartë për t'iu shmangur shërbimit ushtarak
- D) tatimi që në shek. XIX shqiptarët muslymanë paguanin për t'iu shmangur shërbimit ushtarak

029. Traktati i Sh. Stefanit (mars 1878) midis Rusisë dhe Turqisë parashikonte

- A) ndarjen e Shqipërisë Veriore dhe Lindore dhe të Kosovës midis Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi
- B) bashkimin e të gjitha tokave shqipfolëse të Ballkanit në një shtet të vetëm
- C) përfshirjen e Kosovës në shtetin bullgar
- D) përfshirjen e Shqipërisë së mesme në shtetin maqedonas

030. Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare (1877) njihet si

- A) Komiteti i Stambollit
- B) Komiteti Shqiptar Nacionalçlirimtar
- C) Lidhja e Pejës
- D) Komiteti i Korçës

031. Kryetar i Komitetit të Stambollit u zgjodh

- A) Abdyl Frashëri
- B) Sami Frashëri
- C) Pashko Vasa
- D) Jani Vreto-ja

032. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) ishte

- A) një organizatë politike kombëtare mbarëshqiptare, me qëllim mbrojtjen e tërësisë territoriale të trojeve shqiptare
- B) një organizatë kulturore me qëllim ngritjen e nivelit arsimor të popullatës shqiptare
- C) një organizatë fetare për autoqefalinë e Kishës ortodokse shqiptare
- D) një organizatë për izlamizimin e trojeve shqiptare

033. Lidhja e Prizrenit (1878-1881)

- A) kishte degë në të gjitha trojet shqiptare dhe dispononte një ushtri të veten
- B) varej nga Porta e Lartë
- C) ishte nën kontrollin e Fuqive të Mëdha
- D) nuk gjeti mbështetje te popullsia

034. Delegacioni i Lidhjes së Prizrenit që shkoi në Kongresin e Berlinit (1878) kryesohej nga

- A) Abdyl Frashëri
- B) Naim Frashëri
- C) Ali Danish Prishtina
- D) Sulejman Vokshi

035. Traktati i Berlinit (1878)

- A) nuk u njohu shqiptarëve asnjë të drejtë kombëtare dhe çënoi tërësinë territoriale të trojeve të tyre
- B) i përbushi të gjitha kërkesat e shqiptarëve

- C) e përmendte Shqipërinë si një njësi politike
- D) e shtynte për më tej pavarësinë e Shqipërisë

036. Lidhja shqiptare e Pejës (1899-1990) quhej edhe

- A) Besa-Besë
- B) Lidhja e re
- C) Bashkimi
- D) Lidhja Kombëtare

037. Gjatë muajve nëntor-dhjetor 1900, qendresa shqiptare e organizuar nga Lidhja e Pejës në vilajetet shqiptare veri-lindore u mund përfundimisht nga

- A) Mehmet Pasha dhe Shemsi Pasha
- B) Tefik Pasha
- C) Reshat Pasha
- D) Haxhi Zeka

038. Autor i traktatit *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë* (1899) është

- A) Sami Frashëri
- B) Naim Frashëri
- C) Faik Konica
- D) Ismail Qemali

039. Në vitet 1897-1909 Faik Konica botoi në Bruksel dhe më vonë në Londër revistën

- A) Albania
- B) Dituria
- C) Leka
- D) Dashamiri

040. Përpara se të botonte revistën *Fiamuri Arbrit* (1883-1885), Jeronim De Rada botoi revistën

- A) *L'Albanese d'Italia*
- B) *La Nazione Albanese*
- C) *Iliria*
- D) *Vëllazëria Shqiptare*

041. Shoqëria Kombëtare Shqiptare ishte një organizatë kombëtare e krijuar nga fundi i shekullit XIX

- A) nga Abrështë e Italisë
- B) nga Shqiptarët e Misirit
- C) nga Shqiptarët e Rumanisë
- D) nga Arvanitasit e Greqisë

042. Pavarësinë e Shqipërisë e shpalli:

- A) Ismail Qemal Bej Vlora në Vlorë, më 28 nëntor 1912
- B) Fan Stilian Noli në Vlorë, më 29 nëntor 1912
- C) Luigj Gurakuqi në Shkodër më 28 nëntor 1912

D) Bajram Curri në Tiranë, më 28 nëntor 1912

043. Në ç'vit Parlamenti shqiptar e ktheu sistemin politik shqiptar nga republikan në mbretëror?

- A) 1928
- B) 1924
- C) 1932
- D) 1939

044. Ahmet Bej Zogu, Presidenti i Republikës që më 1928 Parlamenti shqiptar shpalli mbret të Shqipërisë, e kishte origjinën nga

- A) Mati
- B) Dukagjini
- C) Devolli
- D) Kastrati

045. Politikani demokrat shqiptar Luigj Gurakuqi u vra

- A) në Bari, më 1925
- B) në Bari më 1936
- C) në Romë më 1938
- D) në Gjirokastrë më 1944

046. Bashkëshortja e Ahmet Zogut Geraldina Apponyi ishte

- A) hungareze
- B) ruse
- C) serbe
- D) rumune

047. Në kohën e mbret Zogut ishte mbizotëruese në Shqipëri

- A) feja islame
- B) feja e krishterë katolike
- C) feja e krishterë ortodokse
- D) ateizmi

048. Trupat italiane të dërguara nga Musolini e zaptuan Shqipërinë më

- A) 1939
- B) 1940
- C) 1944
- D) 1937

049. Kreu i partizanëve shqiptarë që më 1944 dolën fitimtar nga lufta nacionalçlirimtare ishte

- A) Enver Hoxha
- B) Kasëm Trebeshina
- C) Gjon Marka Gjoni
- D) Abaz Kupa

050. Më 1961 RPSSH-ja

- A) prishi marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe lidhi aleancë me Kinën
- B) lidhi aleancë me RFSJ
- C) shpalli ateizmin e shtetit
- D) u përfshi në Paktin e Varshavës

051. Që nga viti 1954 e gjer më 1981 kryeministër i Shqipërisë qe

- A) Mehmet Shehu
- B) Ramiz Alia
- C) Adil Çarçani
- D) Shefqet Sulejmani

052. Kushtetuta e RPSSH-së u reformua duke vënë jashtë ligji çdo shprehje fetare

- A) më 1967
- B) më 1970
- C) më 1965
- D) më 1980

053. Nexhmije Xhunglini ishte gruaja e

- A) Enver Hoxhës
- B) Mehmet Shehut
- C) Ramiz Alisë
- D) Ahmet Hysenit

054. Sipas versionit zyrtar, më 17 dhjetor 1981 Kryeministri i Shqipërisë Mehmet Shehu

- A) vrau veten
- B) u largua nga vendi me një avion rus
- C) vdiq nga një infarkt i zemrës
- D) u vra nga armiku i popullit Thanas Maleshi

055. Diktatori i Shqipërisë Enver Hoxha vdiq

- A) më 11. 04. 1985
- B) më 11. 04. 1991
- C) më 13. 06. 1973
- D) më 25. 05. 1967

056. Më 1985, pas vdekjes së Enver Hoxhës, vendin e Diktatorit në krye të PPSH dhe të shtetit shqiptar e mori

- A) Ramiz Alia
- B) Haxhi Lleshi
- C) Adil Çarçani
- D) Sali Berisha

057. Mbiemri i katër motrave dhe dy vëllezërve që në muajn dhjetor 1985 arritën të futeshin në Ambasadën italiane në Tiranë duke kërkuar strehim politik dhe u lejuan të largoheshin në Itali në muajn maj 1990 ishte

- A) Popa
- B) Panajoti
- C) Papajani
- D) Prennushi

058. E ashtuquajtura “krizë e ambasadave” e muajt korrik 1990 në Shqipëri u shkaktua

- A) nga vërshimi i një mase shqiptarësh në ambasadat e vendeve të huaja në Tiranë, me qëllim që të emigronin
- B) nga mbyllja e të gjitha ambasadave të huaja në Tiranë
- C) nga mbyllja e ambasadave të Shqipërisë në Vendet perëndimore
- D) nga mbyllja e ambasadave të Shqipërisë në Moskë dhe Pekin

059. Regjimi komunist në Shqipëri u rrëzua

- A) më 1991
- B) më 1989
- C) më 1990
- D) më 1993

060. Kryeministër i qeverisë kalimtare shqiptare që më 1991 organizoi zgjedhjet e para të lira të vendit ishte

- A) Fatos Nano
- B) Vilson Ahmeti
- C) Ylli Bufi
- D) Bashkim Fino

061. Zgjedhjet e para pluraliste 31 marsit 1991 në Shqipëri i fitoi

- A) Partia e Punës e Shqipërisë
- B) Partia Socjaliste e Shqipërisë
- C) Partia Demokratike e Shqipërisë
- D) Aleanca për Ardhmërinë e Shqipërisë

062. Kryeministër i Shqipërisë pas zgjedhjeve të para të pluraliste të 31 marsit 1991 qe

- A) Fatos Nano
- B) Sali Berisha
- C) Aleksandër Meksi
- D) Gramos Pashko

063. Zgjedhjet parlamentare të parakohshme të mbajtura në Shqipëri në muajn mars 1992 i fitoi

- A) Partia Demokratike Shqiptare
- B) Partia Socjaliste Shqiptare
- C) Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
- D) Partia Republikane Shqiptare

064. Më 1992, Kuvendi Popullor zgjodhi President të Republikës.

- A) Sali Berishën
- B) Fatos Nanon
- C) Ramiz Alinë
- D) Sabri Godon

065. Shkak i krizës së rëndë që përfshiu Shqipërinë në vitin 1997 qe

- A) rrëzimi i skemave financjare piramidale
- B) rënia e thellë e PBB-së së vendit
- C) rritja e pakontrollueshme e çmimeve
- D) lufta në Kosovë

066. Kushtetuta në fuqi aktualisht në Shqipëri u adoptua me referendum popullor

- A) më 28 nëntor 1998
- B) më 25 nëntor 1997
- C) më 18 janar 1967
- D) më 31 mars 1991

067. Sipas Kushtetutës jugosllave të vitit 1974, Kosova

- A) ishte krahinë autonome e Serbisë me të drejtë vote në Parlamentin Federativ
- B) ishte republikë autonome e RFJ
- C) ishte krahinë autonome pa përfaqësues të vetët në Parlamentin e RFJ
- D) nuk kishte ndonjë formë të veçantë autonomie

068. Në muajin korrik 1990, Parlamenti i RFJ miratoi disa ndryshime në Kushtetën që

- A) ua hiqnin Kosovës dhe Vojvodinës autonominë që gëzonon falë Kushtetutave të viteve 1969 dhe 1974
- B) e bënin Kosoëvn republikë autonome brenda RFJ
- C) e barazonin gjuhën shqipe me gjuhët e tjera të RFJ
- D) krijonin një sistem gjyqësor të veçantë në Kosovë

069. Më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës

- A) shpalli Kosovën republikë të pavarur
- B) u shpërnda nga autoritetet e Beogradit
- C) zgjodhi kryetar të Kosovës dr. Ibrahim Rugovën
- D) shpalli zgjedhje të përgjithshme

070. Zgjedhjet klandestine të organizuara nga Shqiptarët e Kosovës më 24 maj 1992

- A) përfunduan me fitoren e LDK-së dhe zgjedhjen e dr. Ibrahim Rugovës President
- B) dështuan për shkak të pjesëmarrjes së ulët
- C) përfunduan me fitoren e PDK-së
- D) nuk u zhvilluan ngase Beogradi i ndaloi

071. Gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar Kryeministër i qeverisë së Kosovës në mërgim ishte

- A) Bujar Bukoshi

- B) Adem Demaçi
- C) Fatmir Sejdiu
- D) Fehmi Agani

072. Më 24 mars 1999

- A) NATO-ja nisi bombardimet mbi Jugosllavinë
- B) u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë (Rambouillet)
- C) u nënshkrua marrëveshja e Kaçanikut
- D) u vra Adem Jashari

073. UNMIK-u është

- A) misioni i OKBsë përgjegjës për administrimin e Kosovës që nga viti 1999
- B) misioni i NATO-s në Kosovë
- C) një përfaqësi e BE-së në Kosovë
- D) një organizatë humanitare kosovare

074. Në sajë të traktatit të Sen-Zhermen-an-Laj (Saint-Germain -en -Laye) Austria u detyrua t'i lëshonte Italisë

- A) Trentinin, Alto Adixhen, Trieshtën dhe Istrinë
- B) Ligurinë dhe Valle d'Aostan
- C) Lombardinë dhe Veneton
- D) Qytein e Fiumes dhe Dalmacisë

075. Më 1912 Italia pushtoi ushtarakisht

- A) Rodosin dhe ishujt e Dodekanezit
- B) Korfuzin
- C) Shqipërinë dhe Malin e Zi
- D) Qipron

076. Më 12 shtator 1919 Gabriele D'Annunzio (Gabriele D'Annunzio) në krye të një truparmate vullnetarësh arriti të pushtonte

- A) Fiumen
- B) Zarën
- C) Pulën
- D) Trieshtën

077. Ç'ishte politika ekonomike e ndërmarrë nga Musolini më 1936, të cilën ai vetë e quajti autarki?

- A) Një ekonomi kombëtaree mbyllur, e pavarur nga bota e jashtme
- B) Një ekonomi me tipare ndërkombëtare, në lidhje me të gjitha shtetet fqinje
- C) Një qëndrim asnjës në konfliktet e kohës
- D) Fshirja e çdo formë zgjedhesh.

078. Më 1926 vendin e Antonio Gramshit në krye të Partisë Komuniste të Italisë e mori

- A) Palmiro Toljati (Togliatti)
- B) Umberto Terracini

- C) Enriko Berlinguer
- D) Ferruço Parri

079. Të nesërmen e Lutfës së Parë Botërore, kush u cilësua si poeti-ushtar?

- A) Gabriele D'Anunxio
- B) Xhuzepe Ungareti
- C) Euxhenio Montale
- D) Umberto Saba

080. Në qeverinë Xholiti (Giulitti) të fundit (1920 - 1921) ishte ministër i Arsimit

- A) Benedeto Kroçe
- B) Xhovani Xhentile (Giovanni Gentile)
- C) Gabriele D'Anunxio
- D) Gaetano Salvemini

081. Italia u tërhoq nga Shoqeria e Kombeve më

- A) 1937
- B) 1939
- C) 1942
- D) 1933

082. Benito Musolini u ngarkua për herë të parë me formimin e qeverisë në muajn

- A) tetor 1922
- B) korrik 1921
- C) shkurt 1923
- D) shtator 1925

083. Deputeti italian Xhakomo Mateoti i vrrarë më 1924 ishte anëtar i

- A) Partisë Socjaliste unitare
- B) Partisë Popullore italiane
- C) Partisë Komuniste të Italisë
- D) Partisë Republikane

084. Cilën Parti themëloi më 1919 Luixhi Sturco (Luigi Sturzo)?

- A) Partinë Popullore Itlaine
- B) Demokracinë kristiane
- C) Lëvizjen Shoqërorë Italiane
- D) Lëvizjen "Drejtësi dhe Liri"

085. Programi ekonomik dhe shoqëror i fashizmit parashikonte formimin e korporatave, të cilat ishin

- A) Shoqata të kategorive të ndryshme të punonjësve dhe të punëdhënësve
- B) Shoqata të artizanëve dhe punëtorëve
- C) Shoqata punëtorësh, bujqsh dhe nëpunësish

086. Në cilin vend ku kishte luftë civile më 1936, Musolini dërgoi kontingjente ushtarake?

- A) Spanjë
- B) Shqipëri
- C) Jugosllavi
- D) Greqi

087. Gjatë Luftë së Parë Botërore, në Kaporeto

- A) ushtria italiane pësoi një mundje nga ana e austro-hungarezëve dhe gjermanëve
- B) filluan traktativat për armëpushimin midis Italianëve dhe austro-hungarezve
- C) ushtria italiane mundi austro-hungarezët dhe gjermanët
- D) ushtria italiane nisi fushatën kundër austro-hungarezve

088. Më 22 maj 1939, Galeaco Çano-ja (Galeazzo Ciano) dhe Joahim fon Ribentropi (Joachim von Ribbentrop) firmosën aleancën Itali-Gjermani të quajtur

- A) Pakt i çeliktë
- B) Bosht veri-jug
- C) Bosht Romë-Berlin
- D) Pakt Antikomintern

089. Në sajë të cilës normative Shteti italian e njohu martesën katolike (në Kishë) të vlefshme edhe për shtetin?

- A) të Pakteve të Lateranit, të vitit 1929
- B) të së drejtës familjare të vitit 1932
- C) të masave për mbrojtjen e racës së vitit 1939
- D) të ligjit që ngrinte Korporatat, më 1926

090. Antonio Gramshi (që njëri nga themeluesit e

- A) Partisë Komuniste të Italisë
- B) Partisë Socialiste Italiane
- C) Partisë Popullore Italiane
- D) Partisë Socjaldemokrate italiane

091. Si u largua Antonio Gramshi (Gramsci) nga jeta politike?

- A) u arrestua më 1927
- B) u vra në një atentat më 1924
- C) u dergua në mërgim më 1930
- D) u internua në vitin 1926

092. Mbretëria e Italisë u shpall

- A) më 17 mars 1861
- B) më 17 qershor 1874
- C) më 17 mars 1862
- D) më 17 mars 1864

093. Në momentin e shpalljes së tij, mbretëria e Italisë nuk përfshinte

- A) Veneto-n dhe Shtetin e papës
- B) Sardenjën

- C) Mbretërinë e dy Sicilive
- D) Lombardinë dhe Veneto-n

094. Mbreti i parë i Italisë qe

- A) Vitorio Emanuele II
- B) Karlo Alberto
- C) Vitorio Emanuele III
- D) Vitorio Emanuele I

095. Cila marrëveshje parashikonte transferimin e kryeqytetit të Italisë nga Torino në Firenxe?

- A) Konventa e Shtatorit
- B) Marrëveshjet e Olmuc-it (Olmütz)
- C) Pakti i Lovara-s
- D) Marrëveshja e Plombier-it (Plombieres)

096. Cila është përgjigja e famshe e dhënë nga Xhuzepe Garibaldi, kur mori urdhërin për da ndalur përparimin e tij ushtarak, më 1866?

- A) Bindem
- B) Rroftë mbreti
- C) Romë ose vdekje
- D) Pasi e bëmë Italinë, tani duhet të bëjmë italianët.

097. Në Luftën e tretë për pavarësinë, Italia lidhi aleancë me

- A) Prusinë
- B) Anglinë
- C) Austrinë
- D) Francën

098. Lufta e tretë për pavarësinë e Italisë u zhvillua

- A) në gjysmën e dytë të shekullit XIX
- B) nga fundi i shekullit XVIII
- C) në gjysmën e parë të shekullit XIX
- D) nga fillimi i shekullit XX

099. Mbretëria e Italisë e saposhpallur ishte shtet

- A) i centralizuar
- B) federativ
- C) anarkik
- D) i decentralizuar

100. Ushtria italiane pushtoi Romën duke hyrë në qytet nga e çara e Portës Pia më

- A) 1870
- B) 1861
- C) 1871
- D) 1863

101. Kur, më 1912, me paqen e Lozanës, përfundoi lufta midis Italië dhe Turqisë, Italia aneksoi

- A) Libinë dhe Dodekanezin
- B) Dalmacinë dhe Shqipërinë
- C) Shqipërinë dhe Korfuzin
- D) Dodekanezin dhe Rodosin

102. Xhuzepe Garibaldi vdiq më

- A) 1882
- B) 1900
- C) 1871
- D) 1856

103. Pas pushtimit të Romës nga ana e ushtrisë italiane Kisha Katolike u shpreh kundër pjesëmarrjes së katolikëve në zgjedhjet politike me formulën në latinishte

- A) Non expedit
- B) Non docet
- C) Alea iacta est
- D) Non possumus

104. Gjatë perjudhës së Rilindjes kombëtare italiane, kush e themeloi shoqatën “La xhovine Italia” (La Giovine Italia)

- A) Xhuzepe Macini
- B) Kamillo Benso, kont i Kavurit
- C) Xhuzepe Garibaldi
- D) Goffredo Mameli

105. Enciklika *Rerum novarum* e vitit përbën përpjekjen e parë të Kishës Katolike për të marrë përsipër një rol në fushën shoqërore. Me ç’probleme merret ajo?

- A) Me problemet e klasës punëtore
- B) Me problemet e fëmijërisë
- C) Me problemet pjesëmarrjes së popullit në proceset vendimore
- D) Me problemet e fshtarësisë

106. Ç’rol kishin prefektet në organizimin e Mbretërisë së Italisë?

- A) Ishin në krye të provincave
- B) Ishin në krye të prefekturave
- C) Ishin në krye të rajoneve
- D) Ishin në krye të provincave

107. Me cilin negus Italia përfundoi traktatin e Uçalli-t (Ucciali), në vitin 1889?

- A) Menelik-un
- B) Mangasha-në
- C) Selasie-në
- D) Nabukodonosor-in

108. Me cilën popullatë u ndesh ushtria italiane në betejën e Adua-s, më 1896?

- A) Abisinët
- B) Libianët
- C) Turqit
- D) Egjyptianët

109. Cili ishte qëllimi i politikës protecioniste të jetësuar nga qeveritë italianë nga fundi i shekullit XIX?

- A) Mbrojtja e zhvillimit të veprimtarivë prodhuese kombëtare
- B) Nxitja e zhvillimit të sipërmarrësisë private
- C) Parcelizimi i tokave pronë të shtetit
- D) Nxitja e shkëmbimeve të lira me vendet e tjera të Evropës

110. Nga fundi i shekullit XIX, në Itali zhvillimi industrial u përqëndrua veçanërisht në rajonet Piemont, Liguri dhe Lombardi. Si cilësohej kjo zonë zhvillimi?

- A) Trekëndësh industrial
- B) Trekëndësh kapitalist
- C) Trekëndësh prodhues
- D) Trekëndësh i sipërmarrësisë

111. Para Romës, cilat qenë, me radhë, kryeqytetet e Italisë?

- A) Torino dhe Firenxe
- B) Milano dhe Torino
- C) Firenxe dhe Napoli
- D) Firenxe dhe Torino

112. Pse e djathta historike preferoi të jetësonte për Mbretërinë e Italisë një rend administrativ të centralizuar në vend të decentralizimit të kompetencave?

- A) Për të përforcuar bashkimin e sapoarritur
- B) Për t'i kundërshtuar politikës decentralizuese të Kavur-it (Cavour)
- C) Për të përkrahur zhvillimin e krahinave jugore të vendit
- D) Për të penguar forcat politike të kundërta

113. Kush e tha fjalinë e famshme “Italia është e bërë, tani duhet të bëjmë italianët?”

- A) Masimo D'Axeljo (Massimo D'Azeglio)
- B) Kamillo Benso. Kont i Kavurit (Cavour)
- C) Xhuzepe Garibaldi
- D) Xhuzepe Macini

114. E ashtuquajtura “çështje romane” që u lind në Itali në gjysmën e dytë të shekulli XIX kishte të bënte me

- A) Marrëdhëniet midis Shtetit të Papës dhe Mbrerërisë së Italisë
- B) Marrëdhëniet midis Kishës katolike dhe arbëreshve të Italisë të ritit lindor
- C) Marrëdhëniet midis Kishës katolike dhe kishëve protestante
- D) Marrëdhëniet midis Shtetit të Papës dhe Mbretërisë së dy Sicilive

115. Mendimin e Kavur-it (Cavour) lidhur me të ashtuquajturën “çështje romane” e përmbledh shprehja

- A) Kishë e lirë në shtet të lirë
- B) Papa mbretëron, por nuk qeveris
- C) I jepni Cezarit çka është e Cezarit, Kishës çka është e Kishës
- D) Non possumus

116. Cili dokument kushtetues i nxjerrë para bashkimit të Italisë, me shpalljen e Mbrëtërisë së Italisë u bë ligj kushtetues në të gjithë territorin kombëtar?

- A) Statuti Albertin, i nxjerrë nga Karlo Alberto-ja më 1848
- B) Kushtetuta e vitit 1830
- C) Deklarata universale e të drejtave të njeriut
- D) Kushtetuta e nxjerrë nga Karlo Alberto-ja më 1821

117. Pasi më 1943 u shkarkua Musolini, pasardhës i tij në krye të qeverisë italiane u emërua

- A) Pietro Badoljo-ja (Badoglio)
- B) Vitorio Emanuele Orlando-ja
- C) Enriko De Nikola
- D) Xhovani Xholiti (Giovanni Giolitti)

118. Më 1943, Badoljo-ja (Badoglio) e perfundoi armëpushimin me

- A) SHBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe
- B) BRSS-në dhe Gjermaninë
- C) SHBA-në dhe BRSS-në
- D) Mbretërinë e Bashkuar dhe Kinën

119. Në cilin qytet italian ndodhi masakra e Gropave Ardeatine (Fose Ardatine)?

- A) Në Romë
- B) Në Milano
- C) Në Bolonja
- D) Në Trieshtë

120. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesën më të madhe të kampeve të shfarosjes nazistët e organizuan në

- A) Evropën qendrore
- B) Italinë verilindore
- C) Evropën lindore
- D) Gjermani

121. Italia e feston 25 prillin si një tërësi nga data më të rëndësishme të historisë së vetë të shekulli XX sepse është dita e

- A) çlirimit të vendit nga nazifashizmi
- B) vdekjes së Musolinit
- C) zbarkimit të trupave aleate në Anzio (Anzio)
- D) shpalljes së Republikës

122. Kush e kryesonte qeverinë e parë italiane pas çlirimit?

- A) Ferruço Parri
- B) Alçide De Gasperi
- C) Luixhi Einaudi
- D) Karlo Alberto Dalla Kieza

123. Pas çlirimit nga nazifashizmi, cili organizëm u ngarkua me hartimin e Kushtetutës së re të Italisë?

- A) Asambleja Kushtetuese
- B) Gjykata e Lartë
- C) Parlamenti
- D) Qeveria

124. Presidenti i parë i përkohshëm i Republikës Italiane qe

- A) Enriko De Nikola
- B) Luixhi Einaudi
- C) Vitorio Emanuele Orlando
- D) Ferruço Parri

125. Në bazë të Traktatit të paqes të muajt shkurt 1947 Trieshta

- A) u shpall Territor i Lirë
- B) u bashkua përkohësisht me Jugosllavinë
- C) u përfshi brenda kufijve të rinj të Italisë
- D) u bashkua me Slloveninë

126. Aleanca ushtarake që Vendet perëndimore lidhën në vitin 1949 në funksion antisovjetik u emertua

- A) Pakt Atlantik
- B) Pakt i çeliktë
- C) Pakt i Varshavës
- D) Bashkim Perëndimor

127. Në vitin 1953, nën udhëheqjen e Enriko Mateit, në Itali u ngrit një ent publik që edhe sot e kësaj dite, i kthyer në shoqëri aksionare dhe pjesërisht i privatizuar, ka një rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit. Cili?

- A) ENI
- B) SIP-i
- C) IRI
- D) CNEL-i

128. Në cilën organizatë ndërkombëtare u anëtarësua Italia në vitin 1955, bashkë me vende të tjera?

- A) OKB-në
- B) NATO-n
- C) BEE-në
- D) Këshillin e Evropës

129. Kush ishte kryeministër në Itali më 1984, ku u nënshkrua marrëveshja e re midis Shtetit dhe Kishës Katolike, që zëvendësoi atë të vitit 1928?

- A) Betino Kraksi
- B) Xhulio Andreoti
- C) Çiriako De Mita
- D) Xhovani Spadolini

130. Parlamenti i parë evropiaa u zgjodh më

- A) 1979
- B) 1961
- C) 1973
- D) 1981

131. Më 12 dhjetor 1969 në Itali ndodhi një ngjarje jashtëzakonisht e rëndë. Cila?

- A) Ploja e Sheshit Fontana
- B) Ploja e Ustikës
- C) Atentati i trenit Italikus
- D) Vrasja e Gjeneral Karko Alberto Dalla Kieza dhe e gruas së tij

132. Në ç'vit Parlamenti italian miratoi ligjin që e ulte moshën madhore nga 21 në 18 vjet?

- A) 1975
- B) 1980
- C) 1973
- D) 1968

133. Data 10 qershor 1979 është historike për Evropën sepse

- A) shtetasit e vendeve të BEE-së zgjodhën Parlamentin e parë evropian
- B) hyri në fuqi SME-ja (Sistemi Monedhar Evropian)
- C) u fut në qarkullim Euro-ja
- D) BEE-ja firmosi një marrëveshje shkembimi të lirë me BRSS-në

134. SME-ja është

- A) një marrëveshje monedhare ndërkombëtare midis vendeve të BEE-së
- B) një marrëveshje ushtarake midis BE-së dhe Federatës Ruse
- C) një ortakëri industriale evropiane
- D) një sistem për monitorizimin e lundrimit në Mesdheun lindor

135. Rendi kronologjik i pasardhësve të Papë Gjoni XXIII është

- A) Pali VI - Gjon Pali I - Gjon Pali II
- B) Pali VI - Gjon Pali I - Benedikti XVI
- C) Gjon Pali I - Gjon Pali II - Benedikti XVI
- D) Pali VI - Gjon Pali II - Benedikti XVI

136. Cili ishte qëllimi i të ashtuquajturit “kompromis historik” të propozuar për herë të parë nga sekretari i atëhershëm i PKI-së Enriko Berlinguer më 1973?

- A) Bashkëpunimi midis DK-së, PKI-së dhe PSI-së për qeverisjen e vendit
- B) Bashkëpunimi midis PKI-së dhe DK-së, për të përjashtuar PSI-në nga qeverisja e vendit
- C) Bashkëpunimi midis PKI-së, PSI-së dhe PSDI-së për të përjashtuar DK-në nga qeverisja e vendit

137. Brigadat e Kuqe ishin

- A) një organizatë eversive komuniste që veproi në Itali me metoda terroriste gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar
- B) një organizatë paraushtarake e djathtë që kreu atentate në Itali gjatë viteve '70 të shekullit të kaluar
- C) një shoqatë e fshehtë ushtarakësh që synonte të bënte një puç në Itali në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar
- D) një klub dashamirësish të qitjes

138. Themelues të Brigadave të Kuqe më 1970 qenë

- A) Alberto Françeskini dhe Renato Kurço
- B) Renato Kurço dhe Prospero Gallinari
- C) Prospero Gallinari dhe Nadia Desdemona Lioçe
- D) Toni Negri dhe Mario Moretti

139. Kryetari i Demokracisë Kristiane dhe disa herë kryeministër i Italisë Aldo Moro u vra nga Brigadat e Kuqe

- A) në muajn maj 1978
- B) në muajn prill 1978
- C) në muajn korrik 1979
- D) në muajn maj 1977

140. Ku dhe kur u vra gjeneral Karlo Alberto Dalla Kieza?

- A) Në Palermo, më 1982
- B) Në Kapaçi, më 1985
- C) Në Mesina, më 1986
- D) Në Romë, më 1979

141. Cili nga vendet e mëposhtme është anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së?

- A) Kina
- B) Italia
- C) Brazili
- D) Gjermania

142. Në muajn nëntor 1995 ndezi bujë të madhe vrasja e Itzhak Rabin-it. Kush ishte ai?

- A) Kryeministri i Izraelit
- B) Presidenti i Republikës i Izraelit
- C) Kryeministri i Suedisë
- D) Kryetari i OBZHE-së

143. Sa dhe cilët janë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së?

- A) Pesë: SHBA, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Rusia, Kina
- B) Pesë: SHBA, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Rusia Japonia
- C) Gjashtë: SHBA, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Rusia, Kina, Japonia
- D) Katër: SHBA, Franca, Mbretëria e Bashkuar, India

144. Cilat janë vendet më të fundit të anëtarësuara në BE?

- A) Bullgaria dhe Romania
- B) Romania dhe Lituania
- C) Qipro dhe Malta
- D) Malta dhe Kroacia

145. Vendet evropiane që bëjnë pjesë në BE janë

- A) 27
- B) 15
- C) 25
- D) 23

146. Cili nga vendet e mëposhtme nuk përfshihet në zonën euro?

- A) Suedia
- B) Sllovenia
- C) Portugalia
- D) Greqia

147. Anëtarët jo të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së

- A) zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me qarkullim për një dyvjeçar
- B) zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me qarkullim, për një vit
- C) i caktojnë me marrëveshje anëtarët e përhershëm për një dyvjeçar, me qarkullim
- D) i emëron Sekretari i Përgjithshëm me qarkullim për një dyvjeçar

148. Traktati kushtetues i ri i BE-së i firmosur në Romë më 29 tetor 2004 u rrëzua me referendum popullor

- A) nga Franca dhe Hollanda
- B) nga Franca dhe Suedia
- C) nga Hollanda dhe Italia
- D) nga Polonia dhe Gjermania

149. Cili nga vendet e mëposhtme nuk përfshihet në marrëveshjen e Shengenit?

- A) Irlanda
- B) Izlanda
- C) Norvegjia
- D) Luksemburgu

150. Nënë Tereza e Kalkutës u lind në Shkup, nga një familje shqiptare. Emri i saj i lindjes ishte

- A) Gonxhe Bojaxhiu
- B) Nezhmije Pagarusha
- C) Gonxhe Furxhiu

D) Ganimete Pollovina

151. Benito Musolini marshoi drejt Romës në krye të vullnetarëve fashistë

- A) Më 1922
- B) Më 1918
- C) Më 1942
- D) Më 1915

152. Muri i Berlinit u rrëzua

- A) më 1989
- B) më 1961
- C) më 1987
- D) më 1968

153. Cila organizatë ekonomike e themeluar më 1957 shënon faktikisht lindjen e BE-së?

- A) Komuniteti Ekonomik Evropian
- B) Komuniteti Ekonomik i Qymyrit dhe Çelikut
- C) Komuniteti Ekonomik për Enerhgjinë Bërthamore
- D) Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian

154. Në cilin vit njeriu preku me këmbë Hënën?

- A) më 1969
- B) më 1962
- C) më 1968
- D) më 1971

155. Shqiptarët e vjetër të Greqisë quhen nga vendasit

- A) Arvanitas
- B) Arnautë
- C) Vlleh
- D) Arbëreshë

156. Shqiptarët e shpërngulur në Siri njihen atje si

- A) Arnautë
- B) Arbërorë
- C) Albanezulë
- D) Arvanë

157. Arbëreshët e parë mbërritën në Itali para vdelejs së Skënderbeut, për të ndihmuar Alfonsin e Aragonës. Sipas traditës, prijësi i tyre ishte

- A) Dhimitër Reresi
- B) Pal Golemi
- C) Nik Peta
- D) Gjergj Paleolog Hasani

158. Nëna e Skendërbeut e kishte emrin

- A) Vojsavë
- B) Mamicë
- C) Donikë
- D) Elenë

159. Nismëtari dhe shpallësi i autoqefalisë së Kishës Ortodoske Shqiptare është

- A) Fan Stilian Noli
- B) Papa Kristo Negovani
- C) Gjergj Fishta
- D) Pjetër Kamodeka

160. Nënë Tereza e Kalkutës/Gonxhe Bojaxhiu vdiq më 5 shator 1997. Kur e shpalli të lumtur Shenjtëria e tij Papë Gjon Pali i II?

- A) Më 19 tetor 2003
- B) Më 19 tetor 2004
- C) Më 16 janar 2002
- D) Më 9 shtator 2003

161. Cilën nga fjalët italiane të mëposhtme mund ta zëvendësosh me fjalën *dovizia* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Abbondanza
- B) Superbia
- C) Pazienza
- D) Garanzia

162. Ndër foljet italiane të mëposhtme, cila është kalimtare?

- A) Consegnare
- B) Parlare
- C) Accondiscendere
- D) Addivenire

163. Dega e gjuhësisë që studion dialektet quhet

- A) dialektologji
- B) dialektikë
- C) dialektografi
- D) dialektofoni

164. Cila nga foljet italiane të mëposhtme është jokalimtare?

- A) Assurgere
- B) Divenire
- C) Separare
- D) Sconcertare

165. Në një fjalë, dy zanore që shqiptohen veç e veç përbëjnë një

- A) diftong
- B) hiat

- C) digram
- D) dyrokësh

166. Një tekst i hartuar duke përdorur një sistem shkrimi me shifra ose kode të veçanta quhet

- A) kriptogram
- B) diagram
- C) paleogram
- D) proteogram

167. Fjala italiane “ veramente” është

- A) ndajfolje menyre
- B) mbiemër cilësor
- C) ndajfolje kohe
- D) mbiemër përcaktor

168. Cila nga fjalët italiane të mëposhtme është e shkruar me gabim?

- A) Neccessario
- B) Perché
- C) Insistentemente
- D) Soquadro

169. Fjala italiane *cantica* tregon:

- A) njërën nga këngët që përbëjnë një poemë
- B) njërën nga pjesët përbërëse të një soneti
- C) një tregim në vargje me rima të kryqëzuara
- D) një këngë popullore

170. Karmine Abate, njëri nga shkrimtarët më të suksesshëm të viteve të fundit në Itali, e ka origjinë nga një katund arbëresh. Cili?

- A) Karfici
- B) Çifti
- C) Shën Kolli
- D) Hora e Arbëreshve

171. Autori i romanit "*Le sorelle Materassi*", ku përshkruhen karakterë dhe situata të provincës toskane është:

- A) Aldo Palaceski (Palazzeschi)
- B) Italo Svevo
- C) Guido Piovene
- D) Dino Bucati (Buzzati)

172. Kreshnikët, protagonistë të epikës heroike shqiptare, janë

- A) heronj mbrojtës të kufijve të atdheut
- B) heronj të luftimeve antiozmane para Skënderbeut
- C) bashkëluftetarë të Skënderbeut
- D) aleatë të Lek Dukagjini

173. Cilës nga rajonet italiane të mëposhtme i përket ishulli Ponxa?

- A) Lacio-s
- B) Kampanisë
- C) Kalabrisë
- D) Toskanës

174. Aktualisht, Norvegjia është

- A) Monarki kushtetuese
- B) Republikë presidenciale
- C) Republikë federative
- D) Republikë parlamentare

175. Sa janë nenet e Kushtetutës italiane?

- A) 139
- B) 78
- C) 141
- D) 112

176. Në Itali, numri i ministrave është

- A) i ndryshueshëm
- B) fiks
- C) caktohet herë pas here nga Presidenti i Republikës
- D) përkon me numrin e rajoneve

177. Filmin që nxjerr nga "Dekameroni" i Bokaço-s Pier Paolo Pazolini e ambienton

- A) në Napoli
- B) në Romë
- C) në Venedik
- D) në Palermo

178. Gruaja e Xhon Lenon-it ishte

- A) Joko Ono-ja
- B) Linda Istmen-i (Eastman)
- C) Rita Anderson-i
- D) Hedhër (Heather) Mills-i

179. Cili nga kompozitorët e mëposhtëm mbante koncerte nëpër oborret evropiane që nga moshja 6 vjeç?

- A) Mozart-i
- B) Beethoven-i
- C) Bah-u
- D) Monteverdi

180. Bashkëtingëlloret p, b, m janë

- A) buzore

- B) dhëmbore
- C) qiellzore
- D) lëngëtore

181. Cila nga fjalët italiane të mëposhtme është e kunderta e fjalës *lento*

- A) lesto
- B) lecito
- C) spesso
- D) lepidito

182. Personi që brenda të njëjtit territor flet një gjuhë që ndryshon nga gjuha e folur nga shumica e popullatës është:

- A) aloglot
- B) i mërguar
- C) poliglot
- D) dyglot

183. Në italishte fjalët *affinché, accioché, per* janë lidhëza

- A) nënrenditëse qëllimore
- B) bashkërenditëse qëllimore
- C) bashkërenditëse menyre
- D) nënrenditëse shkakore

184. E kryera e thjeshtë, menyrë dëftore, e foljes italiane *presumere* është

- A) presunsi
- B) presumetti
- C) presumei
- D) presumessi

185. Cila nga fjalët shqipe të mëposhtme është sinonim i fjalës *grabitje*?

- A) vjedhje
- B) hajdut
- C) budallallëk
- D) gravurë

186. Pjesorja e shkuar e foljes italiane radere është

- A) raso
- B) raduto
- C) rasato
- D) rasto

187. Fjalja “*hyr, Arben, hyr*” është fjali

- A) nxitëse
- B) mohuese
- C) urdhërore
- D) dëshirore

188. Ndajfolja është

- A) gjymtytë e palakueshme e ligjeratës
- B) gjymtyrë e lakueshme e ligjeratës
- C) pjesë përbërëse e foljes
- D) prefiks fjalëformues

189. Fjalori Etimologjik është fjalor i specializuar

- A) Gjuhësor
- B) Dygjuhësh
- C) Bujqësor
- D) Ekonomik

190. Në fjalinë e thjeshtë “Vëllaj im punonte mësues në fshat”, mësues është

- A) kallëzuesor i kryefjalës
- B) kundrinor i drejtë
- C) rrethanor menyre
- D) përcaktor

191. Në gjuhën shqipe emrat kanë

- A) pesë rasa
- B) nuk ka rasa
- C) 2 rasa
- D) 6 rasa

192. Mbiemri është

- A) gjymtyrë e lakueshme e ligjeratës
- B) pjesëz fjalëformuese
- C) gjymtyrë e palakueshme e ligjeratës
- D) kohë e pashtjelluar e foljes

193. Në gjuhën shqipe

- A) lakohen vetëm mbiemrat që kanë mbaresa të përparme
- B) lakohen të gjithë mbiemrat
- C) lakohen vetëm mbiemrat pa mbaresa të përparme
- D) mbiemrat nuk lakohen

194. Në gjuhën shqipe emri ka

- A) dy trajta: të shquarën dhe të pashquarën
- B) vetëm trajtën e shquar
- C) vetëm traktën e pashquar
- D) tri trajta: të shquarën, të pashquarën dhe të mesmen

195. Vendosni foljen *kam* në kohën e tashme të menyrës dëshirore

- A) paça
- B) paskështa

- C) pafsha
- D) pata

196. Në fjalinë “merre bukën”

- A) trajta e shkurtër e përemrit është ngjitur pas foljes
- B) nuk ka trajtë të shkurtër
- C) trajta e shkurtër është ngjitur pas emrit
- D) trajta e shkurtër nënkuptohet

197. Forma foljore *prunë* është veta e tretë shumëse e kohës së kryer të thjeshtë të foljes

- A) bie
- B) prij
- C) pres
- D) prier

198. Përemri vetor zakonisht shoqërohet nga trajtat e shkurtra në

- A) rasat kallëzore dhe dhanore
- B) rasën rrjedhore
- C) rasën gjinore
- D) rasën thirrore

199. Vendosni foljen *lyej* në kohën e kryer të thjeshtë të menyrës dëftore

- A) leva
- B) lash
- C) lava
- D) lura

200. Në gjuhën shqipe prapashtesa -sisht shërben për të formuar

- A) ndajfolje
- B) mbiemëra të prejardhur
- C) përcjelloren e foljeve
- D) rasën rrjedhore shumëse

201. Gjeni fjalinë me gabime

- A) Luani tha Agronit që të shkojë Romë
- B) Luani i tha Agronit që të shkojë në Romë
- C) Luani i tha që të shkojë në Romë
- D) Luani i tha Agroni se duhet të shkojë në Romë

202. Vendosni foljen “*vjel*” në kohën e tashme të menyrës dëshirore

- A) vjelsha
- B) vjelkështa
- C) vjelça
- D) vjollca

203. “*Duke pandehur*” është

- A) përcjellore pohore e foljes “pandeh”
- B) pjesore e foljes “pandeh”
- C) përcjellore mohore e foljes “pandeh”
- D) paskajore e shkuar e foljes “pandeh”

204. Me cilën fjalë mund ta zëvendësoni fjalën shqipe “*trishtim*” pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë?

- A) hidhërim
- B) trillim
- C) inat
- D) anketim

205. Në gjuhën shqipe ka

- A) vetëm pjesoren e shkuar pjesore
- B) pjesoren e tashme dhe pjesoren e shkuar
- C) nuk ka pjesore
- D) vetëm pjesoren e shkuar veprare

206. Pjesorja e foljes *bie* është

- A) rënë
- B) ratur
- C) bjetur
- D) ranur

207. E kryera e thjeshtë e menyrës dëftore e foljes *shtie* është

- A) shtiva
- B) shtura
- C) shtyta
- D) shtijta

208. Me cilën folje mund ta zëvendësoni fjalën shqipe *vëzhgoj* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) vrojtoj
- B) patrollojë
- C) mbroj
- D) pandeh

209. Me cilën fjalë mund ta zëvendësoni fjalën shqipe *kalamajt* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) fëmijët
- B) gocat
- C) kallogjerët
- D) krushqit

210. Në ligjeratën “*nuk vajta tek Gjoni sepse ai nuk është në shtëpi*”, pjesa “*sepse ai nuk është në shtëpi*” është

- A) fjali e nënrenditur shkakore
- B) fjali e nënrenditur kallëzuesore
- C) fjali e nënrenditur rrethanore
- D) fjali e nënrenditur vendore

211. Në gjuhën shqipe nyja shquese

- A) është e prapavendosur dhe përbën mbaresë të emrit në trajtën e shquar
- B) vihet përpara emrit, në rasën e tij
- C) nuk ekziston
- D) nuk lakohet

212. Gjini emrin me gjini asnjane

- A) mishtë
- B) ushqimi
- C) pula
- D) sheshi

213. Cila nga fjalët shqipe të mëposhtme është e kundërta e fjalës i ëmbël

- A) i hidhët
- B) i thartë
- C) i ashpër
- D) i ngurtë

214. Me cilën fjalë mund të zëvendësosh fjalën *kryelartësi* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) krenari
- B) mendjemadhësi
- C) kokëfortësi
- D) mendjelehtësi

215. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën *mësymje* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) ofensivë
- B) pritë
- C) kurh
- D) fitore

216. Sipas tezës më të akredituar gjuha shqipe është

- A) faza më e vonë e ilirishtes
- B) gjuhë neolatine
- C) faza më e vonë e pelazgishtes
- D) faza më e vonë e trakishtes

217. Gjuha shqipe ka

- A) tri variante kryesore: gegërishten, toskërishten, arbërishten
- B) dy variante kryesore: arbërishten dhe gegërishten

- C) dy variante kryesre: gegërishten dhe toskërishten
- D) katër variante kryesore: gegërishten, toskërishten, arbërishten dhe vllahishten

218. Rotacizmi (zëvendësimi i bashkëtingëllores -n- me bashkëtingëlloren -r- në disa rrethana) është dukuri fonetike tipike

- A) e dialekteve të toskërishtes dhe të arbërishtes
- B) e gegërishtes
- C) e të folmeve labe
- D) e dialektit të Elbasanit

219. Hundorëzimi i zanoreve është dukuri fonetike tipike e

- A) e dialekteve të gegërishtes
- B) e të folmeve shqipe të Greqisë
- C) e dialekteve të toskërishtes dhe të arbërishtes
- D) e dialekteve të Kosovës

220. Alfabeti i shqipes i futur në përdorim nga Shoqëria e Stambollit (1879) ishte

- A) alfabet i përzier me shkronja latine, greke dhe disa shenja të veçanta
- B) alfabet me shkronja krejt greke
- C) alfabet i përzier me shkronja latine dhe cirilike
- D) alfabet me shkronja arabe

221. Kongresi i Manastirit (1908) caktoi për shkrimin e gjuhës shqipe

- A) dy alfabete: alfabetin e Stambollit dhe një alfabet të ri, me shkronja krejt latine
- B) alfabetin e Stambollit
- C) alfabetin e Bashkimit
- D) një alfabet krejt të ri, me shkronja greke

222. Alfabeti i përdorur aktualisht për shkrimin e shqipes është

- A) alfabeti i Manastirit me shkronja krejt latine
- B) alfabeti i caktuar nga shoqata "Bashkimi"
- C) alfabeti i Elbasanit
- D) alfabeti i caktuar nga Kongresi i Ungrës

223. Normat e gjuhës letrare shqipe i caktoi përfundimisht

- A) Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972)
- B) Kongresi i Manastirit (1908)
- C) Kongresi i Lushnjës (1920)
- D) Kongresi i IV i PPSH (1961)

224. Baza e gjuhës letrare së sotme shqipe është

- A) toskërishtja
- B) gegërishtja
- C) dialekti i Elbasanit
- D) gegërishtja letrare

225. Në fjalinë e përbërë “Shkoi në Romë që të merrte pjesë në një Konferencë”, pjesa e nënrenditur është

- A) qëllimore
- B) lejore
- C) kushtore
- D) fthilluese

226. Gjeni fjalën e shkruar në menyrë të rregulltë?

- A) vetëmjaftueshmëri
- B) vetmjaftueshmëri
- C) vetëmjaftueshmri
- D) vetmjaftueshmri

227. Cili është kuptimi i fjalës italiane *epilogo*

- A) mbyllje
- B) ndërprerje
- C) përmbledhje
- D) hyrje

228. Cila është e kundërta e fjalës italiane *ignorante*?

- A) colto
- B) piacevole
- C) intelligente
- D) profano

229. Shkronjat e alfabetit quhen

- A) grafema
- B) digrama
- C) tinguj
- D) fonema

230. Fjala italiane *intanto* është

- A) ndajfolje kohe
- B) lidhëz kohore
- C) lidhëz nënrenditëse
- D) ndajfolje vendi

231. Fjala shqipe *bukur* është

- A) ndajfolje menyre
- B) mbiemër
- C) emër asnjanes
- D) ndajfolje lidhore

232. Pjesorja e kaluar e foljes italiane *ottundere* është

- A) ottuso
- B) nuk ekziston

- C) ottenduto
- D) otteso

233. E kryera e thjeshtë e foljes kalimtare shqipe *bie* është

- A) prura
- B) rava
- C) prora
- D) reva

234. E kryera e thjeshtë e foljes italiane *permanere* është

- A) permasi
- B) permanei
- C) permanetti
- D) permisi

235. E kryera e thjeshtë e foljes shqipe *shoh* është

- A) pashë
- B) peva
- C) shoha
- D) shihja

236. Semantika është

- A) pjesa e gjuhësisë që studion kuptimin e fjalëve
- B) pjesa e gjuhësisë që studion rendin e gjymtyrave të ligjeratës në fjali
- C) shkenca që studion kuptimin e elementeve mbisegmentare të ligjeratës
- D) shkenca që studion sjelljet e njeriut në shoqëri

237. Në gjuhën shqipe lakohen

- A) vetëm mbiemrat me mbaresa të përparme
- B) të gjithë mbiemrat
- C) vetëm mbiemrat pa mbaresa të përparme
- D) mbiemrat nuk lakohen

238. Në gjuhën italiane

- A) mbiemri lakohet sipas gjinisë dhe numrit të emrit që përcakton
- B) mbiemri lakohet sipas gjinisë numrit dhe rasës së emrit që përcakton
- C) mbiemri lakohet sipas numrit të emrit që përcakton
- D) mbiemri nuk lakohet

239. Në gjuhën shqipe mbiemrat

- A) zakonisht vendosen pas emrit që përcaktojnë
- B) mund të vendosen pas ose para emrit që përcaktojnë
- C) zakonisht vendosen para emrit që përcaktojnë
- D) vendosen pas emrit që përcaktojnë kur kanë mbaresën e përparme

240. Cila nga foljet italiane të mëposhtme është jokalimtare?

- A) vivere
- B) conservare
- C) aiutare
- D) significare

241. Cila nga foljet shqipe të mëposhtme është kalimtare?

- A) shmang
- B) ngjaj
- C) gulçoj
- D) flas

242. Gjej gabimin:

- A) orificeria
- B) casaro
- C) cataplasmo
- D) dirozzato

243. Në italiashte banorët e Belgjikës janë:

- A) belgi
- B) belghi
- C) belgiani
- D) belgici

244. Në shqipe banorët e Pakistanit janë:

- A) pakistanezë, pakistanas
- B) pakistanë
- C) pakistanianë
- D) pakistaniotë

245. Shumësi i fjalës italiane *serie* (emër) është

- A) serie
- B) seri
- C) serii
- D) sere

246. Gjej fjalën që nuk ka lidhje me të tjerat:

- A) copiato
- B) massima
- C) dettato
- D) prescrizione

247. Gjej fjalën që nuk ka lidhje me të tjerat

- A) dekoratë
- B) porosi
- C) kërkesë
- D) urdhër

248. Kuptimi i fjalës italiane *facoltoso* është

- A) i pasur
- B) jo i detyrueshëm
- C) që ka të bëjë me një fakultet
- D) që gëzon nam të madh

249. Gjej gabimin:

- A) asprissimo
- B) aspro
- C) asprerrimo
- D) asperità

250. Gjej gabimin:

- A) i stërmath
- B) shumë i madh
- C) i stërmadh
- D) i stramadh

251. Cilën fjalë mund të vësh në vend të fjalës *circuire* pa e ndryshuar domethënien e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Raggirare
- B) Girare
- C) Avvolgere
- D) Ancorare

252. Cilën fjalë mund të vësh në vend të fjalës *mballos* pa e ndryshuar domethënien e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) arnoj
- B) mbuloj
- C) gënjëj
- D) qes

253. Cila është pjesorja e kaluar e foljes italiane *competere*?

- A) nuk ekziston
- B) competuto
- C) competente
- D) competitivo

254. *(Che) io abbia lavorato* është

- A) koha e kryer e menyrës lidhore
- B) koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore
- C) koha më se e kryer e menyrës lidhore
- D) koha e pakryer e menyrës lidhore

255. *Po punoj* tregon

- A) veprim ose gjendje qe vërtetohet në çastin e ligjërimin
- B) veprim të zakonshëm të folësit
- C) veprim që pritet të kryhet në një kohë të papërcaktuar
- D) veprim të pakryer

256. Fjala *qytetar* është

- A) e prejardhur
- B) e përbërë
- C) e thjeshtë
- D) foljore

257. Prapashtesat janë

- A) elemente të fjalës
- B) zanore
- C) lidhëza të bashkëngjitura
- D) fjalë

258. Fjala *marinaio* është fjalë

- A) e prejardhur
- B) e thjeshtë
- C) foljore
- D) e përbërë

259. Gjej fjalën pa gabime

- A) intendenza
- B) interrogabilmente
- C) indraprendenza
- D) inconparabilmente

260. Me cilën fjalë mund të zëvendësosh fjalën shqipe *varfëri* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Skamje
- B) Trembësi
- C) Miroasje
- D) Rrënim

261. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën italiane *raccattare* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Raccogliere
- B) Celare
- C) Carpire
- D) Accattare

262. Cila është e kundërta e fjalës italiane *collera*?

- A) Placidezza
- B) Fretta

- C) Franchezza
- D) Turbolenza

263. Cila është e kundërta e fjalës shqipe *i rraskapitur*?

- A) I fuqishëm
- B) I qëlluar
- C) I gëzuar
- D) I munduar

264. Në det, një anije që timonieri nuk arrin më të mbajë nën kontroll

- A) rravgon
- B) lundron
- C) ngec
- D) përplaset

265. Forma foljore shqipe *pikështa* është

- A) kohë e pakryer e menyrë habitore
- B) kohë e pakryer e menyrës dëftohe
- C) kohë e tashme e menyrës dëshirore
- D) kohë e oakryer e menyrës lidhore

266. Koha e kryer e thjeshtë e menyrës dëftore e foljes italiane *rivalersi* është

- A) io mi rivalsi
- B) io mi rivalei
- C) io mi rivaletti
- D) io mi rivalai

267. Fjala shqipe *afarist* në italishte duhet përkthyer

- A) uomo d'affari
- B) affarista
- C) economista
- D) imprenditore

268. Bashkë me gjuhën italiane, janë gjuhë neolatine

- A) ispanishtja, frengjishtja, rumanishtja, vllahishtja
- B) ispanishtja, anglishtja, frengjishtja, ladinishtja
- C) frengjishtja, shqipja, ispanishtja, anglishtja
- D) rumanishtja, frengjishtja, gjermanishtja, hungarishtja

269. Fjala shqipe *mbret* e ka prejardhjen nga

- A) latinishtja *imperator*
- B) italishtja *impronta*
- C) greqishtja βασιλευς
- D) indoevropianishtja [*amberiter-*]

270. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën italiane *insuccesso* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Fiasco
- B) Trappola
- C) Garbuglio
- D) Pedignone

271. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën shqipe *befas* pa ndryshuar kuptimin e fjalisë ku?

- A) pakujtimas
- B) rëndonjë
- C) vrik
- D) tinëz

272. Shqipja e sotme standarde ka

- A) 36 tinguj (fonema)
- B) 30 tinguj (fonema)
- C) 29 tinguj (fonema)
- D) 27 tinguj (fonema)

273. Sa zanore ka shqipja e sotme standarde?

- A) gjashtë
- B) shtatë
- C) pesë
- D) tetë

274. Veta e dytë njëjës e kohës së kryer të menyrës dëftore të foljes italiane është

- A) scorresti
- B) scorgesti
- C) scorsesti
- D) scorgeresti

275. Njëri nga çiftet foljesh të mëposhtme e ka përkuese formën e vetes së patë shumëse të kohës së tashme të menyrës dëftore. Cili?

- A) Sparire - sparare
- B) Parere - perire
- C) Dare - dire
- D) Scorrere - scorgere

276. Forma e pashtjelluar ngrënë është pjesore e foljes

- A) Ha
- B) Ngre
- C) Ngrij
- D) Ngas

277. me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën *fukarenj* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) Skamnorë

- B) Pasanikë
- C) Të vuajtur
- D) Pushalesh

278. Konvencjonalisht, kufirin gjuhësor midis të folmeve gege dhe të folmeve toske të Shqipërisë e shënon

- A) Shkumbini
- B) Drini
- C) Buna
- D) Vjosa

279. E kundërta e fjalës i përparuar është

- A) i prapambetur
- B) i sprapsur
- C) i prapë
- D) i vrazdhë

280. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën *pisllëk* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) ndyrësi
- B) mospërfillje
- C) mjerim
- D) njollë

281. E kundërta e fjalës *prudenza* është

- A) avventatezza
- B) riguardo
- C) inconsapevolezza
- D) inavvertenza

282. Me cilën fjalë mund ta zëvendësosh fjalën *differire* pa e ndryshuar kuptimin e fjalisë ku ajo ndodhet?

- A) posticipare
- B) differenziare
- C) contrariare
- D) contrastare

283. Forma foljore *shkruakëshim* është

- A) veta e parë shumëse e kohës së pakryer të menyrës habitore
- B) veta e tretë shumëse e kohës të tashme të menyrës habitore
- C) veta e tretë shumëse e kohës së pakryer të menyrës dëftore
- D) veta e parë shumëse e kohës së kryer të thjeshtë të menyrës habitore

284. Forma foljore italiane *posi* është e kryer e thjeshtë e foljes

- A) porre
- B) posare

- C) potere
- D) pozicionare

285. Cilat të folme të shqipes quhen konservative?

- A) Ato që ruajnë grupet bashkëtingëllore *-kl-* dhe *-gl-*
- B) Ato që ruajnë mbaresën *-sh* të rasës rrjedhore shumëse
- C) Ato që kanë menyrën habitore
- D) Ato që e formojnë shumësin me mbaresën *-a*

286. Cili nga humanistët shqiptarë të mëposhtëm është autori i veprës “*Historia de vita et gestis Scanderbegi Epiroticum Principis*”?

- A) Marin Barleti
- B) Marin Beçikemi
- C) Mikel Maruli
- D) Gjon Gazulli

287. Legjenda e Rozafatit është në bazë të themelimit të qytetit të

- A) Shkodrës
- B) Gjirokastrës
- C) Beratit
- D) Lezhës

288. Kanuni i Lekë Dukagjinit është një përmbledhje

- A) ligjesh zakonore
- B) vjershash
- C) përrallash
- D) romanesh mesjetare

289. Libri i parë i gjetur në gjuhën shqipe është

- A) “Meshari” i Gjon Buzukut
- B) “Doktrina e Krishterë” e Ledezmas e përkthyer nga Lekë Matranga
- C) “Cuneus Prophetarum” i Pjetër Bogdanit
- D) “Gjella e Shën Mërisë Virgjër” e Jul Varibobës

290. Fjalori i parë i gjuhës shqipe, i hartuar nga Frang Bardhi, ishte

- A) latinisht - shqip
- B) italisht - shqip
- C) shqip - greqisht
- D) shqip - italisht

291. Varianti gjuhësor i “*Mesharit*” të Gjon Buzukut, të botuar më 1555, është

- A) gegërishtja
- B) toskërishtja
- C) arbërishtja
- D) dialekti i Elbasanit

292. Vepra e Pjetër Bogdanit “Cuneus prophetarum” frymëzohet nga

- A) Bibla
- B) Komedia Hyjnore
- C) Eneida
- D) Iliada

293. Cilën nga veprat e mëposhtme e shkroi Jul Variboba?

- A) Gjella e Shën Mërisë Virgjër
- B) La Creazione del Mondo fino al Diluvio
- C) Notizie su de' Macedoni
- D) De Perpetua Ecclesiae Albanensis

294. “Fjamuri Arbit” është

- A) një revistë arbëreshe e shekulli të XIX
- B) një libër
- C) një tregim
- D) një himn

295. Autori i veprës “L’arpa di un italo-albanese” është

- A) Leonardo De Martino
- B) Kostantino Belluçi
- C) Nikollë Keta
- E) Ernesto De Martino

296. Përveç shtojcës misterioze të dorëshkrimit të quajtur *Bellifortis* të vitit 1405, teksti i shkruar më i vjetër i gjetur në gjuhën shqipe është

- A) Formula e pagëzimit e Pal Engjëllit (Paulus Angelus), e vitit 1462
- B) Fjalori shqip i Arnold fon Harfit (Arnold von Harff)
- C) Ungjilli i Pashkëve i ruajtur në Bibliotekën Ambroziane të Milanos
- D) Mallkimi i përfshirë në komedinë në latinishte “*Epirota*” të Thoma Mediusit (Tommaso di Mezzo)

297. Cilin besim i përkiste poeti i madh shqiptar Naim Frashëri?

- A) Bektashizmit
- B) Islamit sunit
- C) Katolicizmit
- D) Ortodoksisë

298. Naim Frashëri tregon luftën midis pasardhësve të Muhametit në veprën

- A) Qerbelaja
- B) Lulet e verës
- C) Bagëti e Bujqësija
- D) Parajsa

299. Veprën “*Takhayyulat*” Naim Frashëri e shkroi në gjuhën

- A) persiane

- B) greke
- C) turke
- D) latine/shqipe

300. Në cilën nga veprat e mëposhtme Naim Frashëri tregon jetën e Gjergj Kastriot?

- A) Istori e Skënderbeut
- B) Istori e Shqipëris
- C) Dituritë
- D) Bagëti' e Bujqësija

301. Cili është autori i “*O alithis pathos ton Skipetàron*” dhe në cilën gjuhë është ajo?

- A) Naim Frashëri, në greqishte
- B) Sami Frashëri, në greqishte/shqipe
- C) Thimi Mitko, në greqishte
- D) Abdyl Frashëri, në latinishte

302. Jeronim De Rada është njëri nga poetët më të mëdhenj të letërsisë shqipe. Ku u lind?

- A) Në Kalabri
- B) Në Dukagjin
- C) Në Sicili
- D) Në Çamëri

303. Cilën nga veprat e mëposhtme e shkroi Jeronim De Rada?

- A) I Canti di Milosao
- B) Hylli i Dritës
- C) Mili e Hajdia
- D) Brisandi, Lletixja e Ulladheni

304. Frangjisk Anton Santori e botoi romanin e vetë “*Sofia Kominiate*” më

- A) Romani është i pabotuar
- B) 1848
- C) 1849
- D) 1855

305. Cilës rryme letrare i përket Zef Serembe, njëri nga lirikët më të shkëlqyer të letërsisë shqipe?

- A) Romantizmit
- B) Realizmit
- C) Simbolizmit
- D) Ermetizmit

306. Poema “*Lahuta e Malcis*” është e shkruar në variantin gjuhësor geg. Cili është autori i saj?

- A) Gjergj Fishta
- B) Naim Frashëri
- C) Ndre Mjeda
- D) Gjon Nikollë Kazazi

307. Kush i shkroi veprat “Rreze dielli”, “Endra e lotë” dhe “Psallme murgu”

- A) Asdreni
- B) Andon Zako Çajupi
- C) Gavril Dara
- D) Migjeni

308. Më 1897 në Bruksel doli numri i parë i revistës “Albania”. Kush është themeluesi dhe drejtor i saj?

- A) Faik Konica
- B) Françesko Krispi
- C) Fan Stilian Noli
- D) Anselmo Lorekio-ja

309. Njihet me pseudonimet Lek Gruda dhe Jakin Shkodra, është autor i përmbledhjes poetike “Vjersha” dhe e mbylli në menyre tragjike jetën e vetë i varë në Bari më 1925. E kemi fjalën për

- A) Luigj Gurakuqin
- B) Shtjefën Gjeçovin
- C) Vinçenx Prennushin
- D) Medhi Frashërin

310. Autori i poemës “Te dheu i huaj”, i lindur në Horën e Arbëreshve, është

- A) Zef Skiroi
- B) Françesko Krispi Glaviano-ja
- C) Zef Skiro di Maxho-ja
- D) Gavril Dara plaku

311. Poeti shqiptar Lasgush Poradeci njihet për muzikalitetin e veçantë të vargjeve të tij. Cila nga veprat e mëposhtme e ka autor?

- A) Vallja e yjëve
- B) Valët e një shpirti
- C) Vargjet e lira
- D) Jerina ose mbretnesha e luleve

312. Tipari mbizorëzues në veprën e poetit arbëresh Salvatore Braile është ai

- A) satirik
- B) lirik
- C) dramatik
- D) tragjik

313. Ernest Koliqi qe, ndër të tjera, themelues dhe drejtor i revistës së botuar në Itali

- A) Shejzat
- B) La Nuova Albania
- C) Lajmëtari i Arbëreshve
- D) Hylli i Dritës

314. Në vitet 1932 dhe 1936 dolën dy vëllime me titull “Poetët e mëdhenj t’Italis”, antologji e e poezisë italiane e përkthyer në shqipe nga

- A) Ernest Koliqi
- B) Luigj Gurakuqi
- C) Kristo Frashëri
- D) Anton Harapi

315. Autori i përmbledhjes poetike “Vargje të lira” Milosh Gjergj Nikolla njihet me pseudonimin

- A) Migjeni
- B) Asdreni
- C) Mitrush Kuteli
- D) Dushko Vetmo

316. Në cilën rrymë letrare përfshihet shkrimtari shqiptar bashkëhor Dhimitër Shuteriqi?

- A) Realizmin socialist
- B) Ermetizmin
- C) Nihilizmin
- D) Simbolizmin

317. Cili është autori i romanit “Ata nuk ishin vetë?”

- A) Sterjo Spasse,
- B) Dhimitër Shuteriqi
- C) Aleks Çaçi
- D) Kolë Jakova

318. Shtjefën Gjeçovi mblodhi nga goja e popullit dhe, më 1933, botoi korpusin e normave juridike zakonore të njohur si

- A) Kanunin e Lekë Dukagjinit
- B) Kanuni i Malsisë
- C) Kanuni i Skënderbeut
- D) Kanuni i Labërisë

319. Për cilën reformë flet drama “Toka jonë” e Kolë Jakovës?

- A) Reformën agrare
- B) Reformën juridike
- C) Reformën parlamentare
- D) Reformën shoqërore

320. Cila është forma poetike e preferuar nga poeti bashkëkohor shqiptar prej Kosove Enver Gjergjeku?

- A) Soneti
- B) Strofa tetëvargjshe me rimë të kryqëzuar
- C) Vargu i lirë
- D) Strofa katërvargjshe me rimë të puthur

321. Ismail Kadareja konsiderohet shkrimtari shqiptar më i madh i ditëve tona.. Në cilin nga romanet e tij flet për një prift dhe një general italianë?

- A) Gjenerali i ushtrisë së vdekur
- B) Kënga e varrimit;
- C) Çlirimtarët
- D) Kush e soli Doruntinën

322. Shkrimtari Dritëro Agolli është bashkëkohës i

- A) Vorea Ujkos
- B) Gavril Darës
- C) Anton Zako Çajupit
- D) Pashko Vasës

323. “Komisari Nemo” është njëri nga romanet më të mira të

- A) Dritëro Agollit
- B) Fatos Arapit
- C) Pjetër Arbënorit
- D) Visar Zhitit

324. Romani i Ismail Kadaresë “Kështjella” u botua në italishte me titullin

- A) I tamburi della pioggia
- B) La fortezza
- C) L’assedio di Kruja
- D) Il grande inverno

325. Poema e Jeronim De Radës “I Canti di Milosao” flet për

- A) për dashurinë e kundërshtuar midis Rinës dhe Milosaos
- B) shpërnguljen e arbëreshve në Itali
- C) mbrojtjen e kështjellës së Shkodrës
- D) vdekjen e Skënderbeut

326. “E bija e Lalës” është protagonistja e

- A) Poemës “Kënga e sprasme e Balës” e Gavril Darës
- B) Poemës “Specchio di un umano transito” të Jeronim De Radës
- C) Romanit “prilli i thyer” të Ismail Kadaresë
- D) Dramës “Emira” të Frangjisk Anton Santorit

327. Kryevepra e Jeronim De Radës “I Canti di Milosao” u botua për herë të parë në Napoli më 1936. Sa botime pati pas botimit të parë?

- A) Dy
- B) Tre
- C) Një
- D) Katër

328. Cilën vepër të letërsisë latine të kujton poema “Bagëti’e bujqësija“ e Naim Frashërit?

- A) “Georgicae” të Virgjilit

- B) “De rerum natura” të Lucrezit
- C) “Metamorphoses” të Ovidis
- D) “Carmen saeculare” të Oracit

329. Në shkullin XVII, në Shqipëri mori hov një rryma letrare e bejtexhinjve. Si e shkruanin shqipen këta poetë?

- A) Me alfabetin arab
- B) Me alfabetin grek
- C) Me alfabetin turk
- D) Me alfabet të përzier arabo-grek

330. Poezia e bejtexhnjve ndikohej fort nga modelet letrare

- A) turke, persiane dhe arabe
- B) turke dhe greke
- C) persiane, italiane dhe greke
- D) turke dhe italiane

331. Divani është

- A) një përblehdje poezish orientale me një renditje të veçantë
- B) një vëllim lutjesh
- C) një përblehdje tregimesh për profitin Muhamet
- D) një përblehdje rregullash të bejtexhinjve

332. Dorëshkrimi i quajtur “Anonimi i Elbasanit” (1761) përmban

- A) pjesë të katër Ungjijve të përkthyer në gjuhën shqipe
- B) vjersha bejtexhinjsh
- C) lutje në gjuhën shqipe kushtuar Sh. Mërisë Virgjër
- D) përkthime nga Dhjata e Vjetër në gjuhën shqipe

333. Hasan Zyko Kamberi (gjysma e dytë e shekullit XVIII) ishte poet

- A) bejtexhi
- B) romantik
- C) fetar
- D) iluminist

334. Jul Variboba (1724-1788) e botoi veprën e vetë “Gjella e Shën mërisë virgjër” më

- A) 1762
- B) 1777
- C) vepra ngeli e pabotuar
- D) 1758

335. I lindur në Mbuzat (it. S. Giorgio Albanese, në provincën e Kozencës) Jul Varibota vdiq

- A) në Romë më 1788
- B) në vendlindje më 1762
- C) në Kozencë më 1785
- D) në Napoli më 1788

336. Poema e Jeronim De Radës “Canti di Serafina Topia principessa di Zadrina” rrëfen

- A) dashurinë e kundërshtuar midis bijës së dukës së Artës dhe Bozdar Stresit
- B) dashurinë e kundërshtuar midis bijës së dukës së Artës dhe Nikollë Dukagjinit
- C) shpërnguljen e arbëreshëve në Itali
- D) ikjen e koronejve nga Morea

337. Vjershat e Zef Serembes në gjuhën shqipe

- A) i botoi nipi i tij Kozmo më 1926 me titullin “Vjersha”
- B) i botoi autori në Niu Jork më 1895, me titullin “Arbri i Ri”
- C) janë të pabotuara
- D) i botoi nipi i tij Kozmo më 1901, me titullin “Vjersha”

338. Zef Serembe shkroi dhe botoi disa vepra poetike në italishte. Cila nga të mëposhtmet nuk është e tijja?

- A) *Poesie varie*, Napoli 1862
- B) *Poesie italiane e canti originali tradotti dall'albanese*, Cosenza, 1883
- C) *Il reduce soldato, ballata lirica*, Neë York, 1895
- D) *Sonetti vari*, Napoli 189?

339. Romani i Ismail Kadarësë “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut” u botua në italiashte me titull

- A) Vita, avventure e morte di un attore
- B) Il grande inganno
- C) Vite spezzate
- D) La fuga

340. Në përmbledhjen poetike “Lulet e verës”, Naim Frashëri arrin të shkrij bukur ndikimin e klasikëve persianë me idealizmin e vetë atdhetar. Ku dhe kur e botoi ai këtë përmbledhje?

- A) më 1890, në Bukuresht
- B) më 1886, në Stamboll
- C) më 1898, në Bukuresht
- D) më 1890, në Stamboll

341. Albanus Albano, autori i romanit në gjuhën frënge me titull “Dardha de Temal” të botuar në Paris më 1890, në të vërtetë ishte

- A) Pashko Vasa
- B) Ismail Qemali
- C) Sami Frashëri
- D) Jani Vreto

342. Përpara se të merrte emrin “Diturija” gazeta e botuar më 1894-1895 në Stamboll nga Shoqëria e të Shtypuri Shkronja shqip e ishte emrin

- A) Drita
- B) Arbri i Ri
- C) Shqipëria

D) Besa

343. Më 1902, Andon Zako Çajupi botoi një Kajro përmbledhjen poetike

- A) Baba Tomorri
- B) Malet e Shqipërisë
- C) O moj Shqypni
- D) Psallme murgu

344. Përmbledhja poetike “Vargjee të lira” (1944) e Migjenit përfaqëson një risi revolucionare në letërsinë shqipe. Pse?

- A) Autori braktis temën kombëtare dhe, për herë të parë në letërsinë shqipe, flet për realitetin e vrazdhë të jetës, për mjerimin dhe vuajtjet e popullit
- B) Është vepra e parë e letërsisë shqipe e shkruar në vargje të lira
- C) Autori mbron tezën e bashkimit të të gjithë trevave shqipfolëse të Ballkanit
- D) Autori shpall hapur ideologjinë e vetë marksiste

345. Përmbledhja poetike “Kangjelet e Rilindjes” (1959) e Ernest Koliqit frymëzohet nga

- A) vizita e autorit pranë Arbëreshve të Kalabrisë
- B) Rilindja kombëtare
- C) Lufta antifashiste nacionalçlirimtare
- D) Cikli folklorik i Kreshnikëve

346. Përmbledhja poetike “Lum Lumi” (1982) mund të konsiderohet njëra nga veprat më mjeshtërore të poetit kovovar Ali Podrimja. Për kë e ka fjalën autori në titull?

- A) Për djalin e vetë Lum, që i vdiq
- B) Për Drinin Bardhë, si damar i madh që lidh dhe ushqen trojet shqipfolëse
- C) Për historinë, si lum që nuk mbaron kurrë së rrjedhuri
- D) Për djalin e vetë Lum, me rastin e lindjes së tij

347. Përveç Dekameronit, Xhovani Bokaço-ja shkroi shumë vepra në latinishte. Cilën nga veprat e mëposhtme nuk e shkroi ai?

- A) Secretum
- B) Filocolo
- C) Teseida
- D) Filostrato

348. Cila nga veprat e mëposhtme përmbledh vjershat rinore të Dante Aligierit kushtuar gruas së dashur, Beatrices?

- A) Vita nova (Jeta e re)
- B) Tresor
- C) De vulgari eloquentia
- D) Rime

349. Vetëm njërën nga veprat e mëposhtme nuk e shkroi Xhakomo Leopardi. Cilën?

- A) Secretum
- B) Operette morali

- C) Zibaldone
- D) Canti

350. Cila nga veprat e mëposhtme nuk është e Xheim Xhois-it (James Joyce)?

- A) The side of the paradise
- B) Ulysses
- C) Dedalus
- D) Dubliners

351. Ngjarjet e treguara nga njëra ndër tragjeditë e shkruara nga Alesandro Manzoni (Manzoni) zhvillohen në kohën e zaptimit të Italisë longobarde nga ana e Frëngëve. Cila është kjo tragjedi?

- A) Adelchi
- B) Virginia
- C) I Promessi sposi
- D) Il Conte di Carmagnola

352. Më 1904 Luixhi Pirandello-ja botoi një roman shumë të suksesshëm. Cilin, ndër të mëposhtmit?

- A) Il fu Mattia Pascal
- B) Uno nessuno e centomila
- C) Suo marito
- D) L'esclusa

353. Më 1945 Karlo Levi përshrkoi mjeshtërisht botën fshatare të Italisë së jugut në romanin

- A) Cristo si è fermato ad Eboli
- B) Confessioni di un italiano
- C) Paura della libertà
- D) Il futuro ha un cuore antico

354. Romani “Agnese va a morire”, i botuar më 1949, tregon historikun e një gruaje që merr pjesë në Rezistencën antifashiste në Itali. Atë e shkroi

- A) Renata Viganò-ja
- B) Dacia Maraini
- C) Carlo Cassola
- D) Elsa Morante-ja

355. Vepra e Çezare Pavese-s *Lavorare stanca* është

- A) përmbledhje poetike
- B) ese mbi punën në fabrika
- C) përmbledhje tregimesh
- D) ese filosofike

356. Më 1889 Gabriele D’Anunzio botoi njërin nga romanet e tij estetikisht dhe stilistikisht më të stërholluara. E kemi fjalën për

- A) Il piacere
- B) L’innocente

- C) Il trionfo della morte
- D) Forse che sì forse che no

357. Protagonistët e romanit shumë të suksesshëm të Elsa Morante-s *La storia* janë njerëz të thjesht dhe krejt të pambrojtur përpara dhunës së botës dhe të historisë. Në cilin dhjetëvjeçar të shekullit XX u botua ky roman?

- A) Vitet '70
- B) Vitet '50
- C) Vitet '80
- D) Vitet '40

358. Cila nga veprat e mëposhtme të Ugo Foskolo-s u frymëzua pjesërisht nga romani epistolar i Gëtes (Goethe) *Die Leiden des jungen Werthers*?

- A) Ultime lettere di Jacopo Ortis
- B) I sepolcri
- C) Le Grazie
- D) Notizia di Didimo Chierico

359. Trilogjia *Gli Antenati* e Italo Kalvino-s është një përmbledhje “përrallash moderne”, siç e quan vetë autori, të botuara gjatë viteve 1952-1959. Cila nga “përrallat” e mëposhtme përfshihet në të?

- A) Il barone rampante
- B) Marcovaldo
- C) Ti con zero
- D) Cosmocomiche

360. Më 1955 Pier Paolo Pazolini botoi njërin nga romanet e tij më të forta. Cilin?

- A) Ragazzi di vita
- B) Il sogno di una cosa
- C) Comizi d'amore
- D) La meglio gioventù

361. *Ossi di seppia* mbase është njëri nga titujt më të famshëm të letërsisë italiane të shekullit XX. Për ç'është fjala?

- A) Për një përmbledhje poetike të Euxhenio Montale-s
- B) Për një roman të Alberto Moravia-s
- C) Për një përmbledhje poetike të Salvatore Kuazimodos
- D) Për një përmbledhje tregimesh të Italo Kalvino-s

362. Shumë nga shkrimtarët italianë bashkëkohorë më të shquar e kanë origjinën nga Sicilia. Cili nga të mëposhtmit nuk është sicilian?

- A) Xhusepe Berto
- B) Salvatore Kuasimodo
- C) Elio Vitorini
- D) Leonardo Shasha (Sciascia)

363. Më 1975 Çmimin Nobel për Letërsinë e mori poeti italian

- A) Euxhenio Montale
- B) Alberto Moravia
- C) Dario Fo
- D) Xhuzepe Ungareti

364. Poetët Gocano (Gozzano), Koracini (Corazzini) dhe Moreti (Moretti) u cilësuan nga kritika bashkëkohëse si

- A) Krepuskolarë
- B) Simbolistë
- C) Hermetikë
- D) Dekadentistë

365. Nga cili vend e Amerikës latine e ka origjinën shkrimtari Horhe Luis Borhes-i (Jorge Luis Borges), që mbahet të jetë njeri nga autorët bashkëkohor më të shquar në shkallë botërore?

- A) Argjentina
- B) Brazili
- C) Kolombia
- D) Kili

366. “*Quer pasticciaccio brutto de Via Merulana*” është njëfarë romani policor që përfundon duke e lënë lexuesin më shumë pikëpyjtje të pazgjidhura. Cili është autori i tij?

- A) Karlo Emilio Gada
- B) Karlo Kasola
- C) Karlo Sgorlon-i
- D) Karlo Maria Nikolai

367. Në cilin nga romanet e veta, Albert Kamjus-i (Camus) përshkruan format e shumta me të cilat e keqja shfaqet në botë?

- A) La peste
- B) L'Étranger
- C) La chute
- D) Caligola

368. Romani *La Nausée*, i botuar më 1930 mbahet të jetë manifesti i pesimizmit ekzistencial Frances të pjesë së parë të shekullit XX. Autori i tij është

- A) Zhan Pol Satr-i (Jean Paul Sartre)
- B) Rolan Bartsh-i (Roland Barthes)
- C) Andre Zhid-i (André Gide)
- D) Rajmon Kuono-ja (Raymond Queaneau)

369. Pëveç që tregimtar, skenarist, dhe regjisor, Pier Paolo Pazolini qe edhe poet shumë i vlerësuar. Cila nga veprat e tij të mëposhtme nuk është përmbledhje poetike?

- A) Accattone
- B) La meglio gioventù
- C) Diarii

D) Transumanar e organizzar

370. Autori i romaneve *Il diavolo sulle colline, La Luna e falò, La bella estate* është

- A) Çezare Paveze-ja
- B) Karlo Kastellaneta
- C) Gofredo Parize-ja
- D) Mario Soldati

371. Çarls Dikens-i (Charles Dickens) është autor i shumë romaneve me temë shoqërore. Cilin nga romanet e mëposhtme nuk e shkroi ai?

- A) The longest journey
- B) A Christmas Carol
- C) Dombey and son (Dombi e biri)
- D) David Copperfield (David Koperfildi)

372. Ludoviko Ariosto (1474 - 1533) është autori i poemës kalorësiake më të njohur të letërsisë italiane. Cili është titulli i poemës?

- A) Orlando furioso
- B) Gerusalemme liberata
- C) Rinaldo
- D) Orlando innamorato

373. Botimi i përmbledhjes poetike *Les fleurs du mal* (Lulet e se keqes, 1857) shënoi një revolucion të mirëfilltë në shijen estetike të kohë. Cili është autori i saj?

- A) Charl Bodler-i (Charles Baudelaire)
- B) Pol Verlen-i (Paul Verlaine)
- C) Gystav Flober-i (Gustave Flaubert)
- D) Stendal-i (Stendhal)

374. Poema eroike *Gerusalemme Liberata* konsiderohet njëra nga kryeveprat e letërsisë italiane. Cili është autori i saj dhe në cilin shekull e hartoi?

- A) Torkuato Taso-ja, në shek. XVII
- B) Mateo Maria Boiardo-ja, në shek. XVI
- C) Torkuato Tasso-ja, në shek. XVI
- D) Ludoviko Ariosto-ja, në shek. XVII

375. Cili nga shkrimtarët dhe poetët italianë të mëposhtëm nuk e mori kurrë Çmimin Nobel për letërsinë?

- A) Mario Luzi
- B) Luixhi Pirandello-ja
- C) Salvatore Kuazimodo-ja
- D) Gracja Deleda

376. Primo Levi shkroi shumë vepra që kanë për objekt ngjarje të ndodhura realisht dhe të përjetuara nga autori gjatë luftës së dytë botërore. Cilën nga veprat e mëposhtme nuk e shkroi ai?

- A) La ciociara
- B) Se questo è un uomo
- C) La chiave e la stella
- D) La tregua

377. Romani *Il nome della rosa* mbase është njëra nga veprat letrare më të suksesshme të shekullit XX. Autori i tij është

- A) Umberto Eko-ja
- B) Xhorxho Saviane-ja
- C) Antonio Tabuki
- D) Xhorxho Basani

378. Më 1857 Gystav Flobër-i (Gustave Flaubert) botoi një roman ku protagoniste është një grua që përpëlitet midis dëshirës për një jetë të jashtëzakonshme dhe realitet të rëndomtë të përditshmërisë. Cili është titulli i romanit?

- A) Madame Bovary (Zonja Bovari)
- B) L'Éducation sentimental
- C) Trois Contes
- D) Les fleurs du mal (Lulet e së keqes)

379. Në veprën *Il Principe* shqyrtohen thellë ligjet e jetës politike dhe zbatimi i tyre nga ana e një lloji të ri princi. Autor i veprës është

- A) Nikolò Makiavelli
- B) Çezare Bekaria
- C) Antonio Rozmini
- D) Lorenzo de' Mediçi

380. Romani *Doktor Faustus*, i botuar më 1947 është vepra e pjekurisë e shkrimtarit të madh gjerman

- A) Thomas Man (Mann)
- B) Herman Hese (Hermann Hesse)
- C) Bertold Breht (Brecht)
- D) Hainrih Man (Heinrich Mann)

381. Veprën *Ultime lettere di Jacopo Ortis* e Ugo Foskolo-s rrëfen dashurinë midis Jakopo Ortis-it dhe Terezës. Si përfundon historiku?

- A) Jakopo-ja vret veten
- B) Tereza bie në dashuri me një burr tjetër
- C) Jakopo dhe Tereza martohen
- D) Tereza vdes nga tuberkoloza

382. Cili nga intelektualët francezë të mëposhtëm refuzoi çmimin Nobel për Letërsinë më 1965?

- A) Zhan Pol Sartr-i (Jean Paul Sartre)
- B) Zherard Zhenet-i (Zherard Genette)
- C) André Zhid-i (Andr° Gide)
- D) Zhak Prever-i (Jaques Prevert)

383. Pas *Menzogna e sortilegio-s*, *L'isola di Arturo*, i botuar më 1957, është romani i dytë i një shkrimtarje italiane që dallohet për nga struktura e veçantë e tregimit të vetë. E kemi fjalën për

- A) Elsa Morante-n
- B) Maria Korti-n (Maria Corti)
- C) Daçia Maraini (Dacia Maraini)
- D) Oriana Fallaçi-n (Oriana fallaci)

384. Autori i librit *Le avventure di Pinocchio* njihet me pseudonimin *Kollodi* (Collodi). Cili është emri i tij i vërtetë?

- A) Karlo Lorenxini
- B) Luixhi Kapuana
- C) Antonio Fogacaro (Fogazzaro)
- D) Xhuzepe Rovani

385. Vepra *La Comedie humane* e Honore dë Balzak-ut (Honoré de Balzac) është

- A) një përmbledhje romanesh dhe tregimesh
- B) një roman
- C) një përmbledhje vjershash
- D) një novelë

386. Autorin i përmbledhjes së famshme *Spoon river anthology* të botuar më 1915 është

- A) Edgar Lii Masters-i (Edgar Lee Master)
- B) Uolt Uitman-i (Walt Whitman)
- C) Thomas Strerns Eliot-i (Thomas Stearns Eliot)
- D) Fransis Skot Ficxherald-i (Francis Scott Fitzgerald)

387. Cili nga romanet e Ernest Heminguej-t flet për luftën civile në Spanjë?

- A) For whom the bells tolls (Për kë bien kambanat)
- B) Winner take nothing
- C) The old man and the see (Plaku dhe deti)
- D) A fareëell to arms

388. Në cilën nga veprat e mëposhtme të Luixhi Pirandello-s të gjithë portagonistët janë aktorë në kërkim të një teksti të caktuar?

- A) Sei personaggi in cerca d'autore
- B) Il gioco delle parti
- C) Questa sera si recita a soggetto
- D) Così è (se vi pare)

389. Në veprën *Hamlet* të Uilliam Shekspir-it (William Shakespeare), nëna e protagonistit Gertruda është mbretëresha e

- A) Danimarkës
- B) Skocisë
- C) Norvegjisë
- D) Anglisë

390. Arpagoni, Eliza dhe Valeri janë personaxhe të komedisë së Molier-it me titull

- A) L'avare ou L'école du mensonge (Kopraci)
- B) Tartuffe ou l'Imposteur (Tartufi)
- C) Dom Juan ou le Festin de Pierre (Don Zhuani)
- D) Le bourgeois gentilhomme (Borgjezi fisnik)

391. Pier Paolo Pasolini (Pasolini) qe jo vetëm poet dhe shkrimtar, por edhe regjisor shume i vlerësuar. Cilin nga filmat e mëposhtëm nuk e drejtoi ai?

- A) Un borgeze piccolo piccolo
- B) Il Vangelo secondo Matteo
- C) Uccellacci e uccellini
- D) Accattone

392. Në cilin nga romanet e mëposhtme Aleksadr Dymas-i (Dumas) flet për dashurinë midis Armand Dyvalit (Duval) dhe kurtizanës Margerita Gotié (Marguerite Gautier)

- A) La Dame aux camélias (Zonja me kamelje)
- B) Le Roman d'une femme
- C) La Dame aux perles
- D) Trois Hommes forts

393. Qyteti ku zhvillohet tragjedia e Uilliam Shekspirit (William Shakespeare) me protagonist Othello-n është

- A) Venediku
- B) Parisi
- C) Kopenhaga
- D) Verona

394. Si përfundon Dezdemonja, bashkëprotagonistja e tragjedisë së Uilliam Shekspirit (William Shakespeare) "Othello"

- A) e vret burri
- B) ikën nga shtëpia martësore
- C) ikën me të dashurin
- D) vret veten

395. Më 1949, Xhorxh Oruell-i (George Orwell) botoi një roman ku përshkruhej një diktaturë rrëqethëse mbarëbotërore. Titulli i romanit është

- A) 1984
- B) Big brother
- C) The master of the world
- D) Dr. Ox' experiment

396. Xh.K. Rouling (J. K. Rowling) shkroi sagën e famshme "Harry Potter". Cila shenjë e karakterizon protagonistin e saj?

- A) një mbresë në formë rrufeje në ballë

- B) i mungon një gisht o dorës
- C) flokët e kuq
- D) syzet në formë gjysmë hëne

397. Kush e shkroi romanin e famshëm “Pride and Prejudice”?

- A) Xhein Osten-i (Jane Austen)
- B) Henri Filding-u (Henry Fielding)
- C) Sharlot Bront-i (Charlotte Brontë)
- D) Agatha Kristi (Agatha Christie)

398. Sa rrokje ka dhe ku del për herë të parë fjala më e gjatë e italishtes?

- A) 11 rrokje, në Komedinë Hyjnore
- B) 13 rrokje, në Dekameronin
- C) 10 rrokje, në “I Promessi Sposi” (Të fejuarit)
- D) 14 rrokje, në “I Malavoglia”

399. Gruaja që frymëzoi poezitë e Xhovanni Petrarka-s e kishte emrin

- A) Laura
- B) Fiameta
- C) Beatriçe
- D) Erminia

400. Njëri nga shkrimtarët më të suksesshëm të kohëve të fundit, është Khaled Hoseini. Nga cili vend e ka origjinën?

- A) Nga Afganistani
- B) Nga Irani
- C) Nga Maroku
- D) Nga Pakistani

401. Romani “Buddenbrooks” rrëfen ngritjen dhe rënien e një familjeje të madhe gjermane. Autori i tij është

- A) Thomas Man-i
- B) Johan Volfang fon Gëte (Johan Wolfgang von Goethe)
- C) Gunter Gras-i
- D) Robert Muzil-i

402. Rënia e Mbretërisë së dy Sicilive dhe kriza e një jete që po përjeton një transformin shoqëror të thellë është subjekti i romanit “Il Gattopardo”. Autori i tij është

- A) Xhuzepe Tomazi di Lampeduza
- B) Xhovani Verga
- C) Luixhi Pirandello-ja
- D) Leonardo Shasha

403. Verizmi është një rrymë letrare italiane që karakterizoi dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX dhe fillimin e shek. XX. EkspONENTI i tij më kryesor është

- A) Xhovani Verga

- B) Antonio Fogacaro (Fogazzaro)
- C) Umberto Saba
- D) Elio Vitorini

404. Në cilin gjuhë i shkroi romanet e veta të para shkrimtari italian me origjinë arbëreshe Karmine Abate?

- A) Gjermanishte
- B) Italishte
- C) Arbërishte
- D) Anglishte

405. Cili është emri i lindjes i poetit të shquar bashkëkohor arbëresh të njohur si Vorea Ujko?

- A) Domeniko Bellici (Bellizzi)
- B) Françesko Solano
- C) Xhuzepe Del Gaudio
- D) Agostino Ribeko

406. “La moto di Scanderbeg” mbase është romani më i mirë i njërit nga shkrimatrët italianë më të sukseshëm të viteve të fundit. Autori i tij është:

- A) Karmine Abate-ja
- B) Stefano Beni (Benni)
- C) Federiko Moça
- D) Saverio Strati

407. Temë e rapsodisë shqiptare të njohur si Kostantini e Garentina (ose Doruntina, ose Jurëndina) është ngritja e një personi (në këtë rast e Kostantinit) nga varri për të mbajtur besën e dhënë. Si përfundon legjenda?

- A) Kostantini e kthen motrën në shtëpi, por Garentina dhe nëna vdesin
- B) Kostantini e kthen motrën në shtëpi dhe ajo jeton me nënën
- C) Garentina refuzon të kthehet në shtëpi dhe nëna vdes
- D) Garentina pranon të kthehet në shtëpi, por vdes rrugës

408. Porti i parë italian për nga lëvrimi i mallrave është

- A) Xhenova
- B) Napoli
- C) Villa San Xhovanni
- D) Ankona

409. Në cilën provincë të Italisë është veçanërisht e përqëndruar industria e mëndafshit?

- A) Komo
- B) Prato
- C) Peskara
- D) Vareze

410. Në cilën Federatë bënte pjesë Republika e Sllovenisë?

- A) Federatën Jugosllave

- B) Federatën Helvetike
- C) Federatën Ruse
- D) Federatën Austriake

411. Në gjendjen e tanishme, cilat janë zyrtarisht Shtetet e lindura nga shpërbërja e Republikës Federative të Jugosllavisë?

- A) Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi
- B) Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Hercegovina, Federata e Re Jugosllave
- C) Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Federata Serbi-Ma i Zi
- D) Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Federata e Re Jugosllave

412. Në cilin Shtet të Evropës jeton grupi etnik bask?

- A) Spanjë
- B) Andorrë
- C) Portugali
- D) Francë

413. Cila nga gjuhët e mëposhtme nuk është gjuhë zyrtare e Federatës Helvetike?

- A) Ispanishtja
- B) Gjermanishtja
- C) Italishtja
- D) Frengjishtja

414. Ndër shtetet e mëposhtme, vetëm njëri është Republikë. Cili?

- A) Hungaria
- B) Hollanda
- C) Spanja
- D) Belgjika

415. Mbi Ishujt Malvinas të Atlantikut Jugor sovranitetin e ushtron

- A) Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe
- B) Hollanda
- C) Argjentina
- D) Spanja

416. Shqipëria kufizohet me:

- A) Malin e Zi, Kosovën (Serbinë), Maqedoninë, Greqinë
- B) Malin e Zi, Maqedoninë, Greqinë
- C) Federatën e Re Jugosllave, Maqedoninë, Greqinë
- D) Malin e Zi, Federatën e Re Jugosllave, Greqinë

417. Bergamo është provincë e rajonit italian

- A) Lombardi
- B) Toskanë
- C) Kalabri
- D) Sicili

418. Vendi që prodhon më shumë verë në Evropë është

- A) Italia
- B) Spanja
- C) Franca
- D) Austria

419. Rrethi i Permetit përfshihet në Qarkun e

- A) Gjirokastrës
- B) Vlorës
- C) Elbasanit
- D) Korçës

420. Kryeqyteti i Malit të Zi është

- A) Podgorica
- B) Titogradi
- C) Cetinja
- D) Beogradi

421. Aktualisht, Shqipëria është

- A) Republikë parlamentare
- B) Republikë federative
- C) Republikë popullore
- D) Republikë presidencjale

422. Në cilin vend evropian ndodhet porti i Dancigut?

- A) Poloni
- B) Gjermani
- C) Rusi
- D) Lituani

423. Me cilin nga vendet e mëposhtme kufizohet Zvicra?

- A) Gjermaninë
- B) Belgjikën
- C) Slloveninë
- D) Danimarkën

424. Liqeni i Shkodrës ndodhet

- A) midis Shqipërisë dhe Malit të Zi
- B) midis Shqipërisë dhe Serbisë
- C) midis Malit të Zi dhe Serbisë
- D) në Kosovë

425. Drini i Bardhë i ka burimet

- A) afër Pejes, në Kosovë
- B) afër Shën Naumit, në Maqedoni

- C) në liqenion e Ohrit
- D) në Malet e Sharrit

426. Prizreni ndodhet

- A) në pjesën jugore të Kosovës
- B) në veri-lindje të Prishtinës
- C) në pjesën lindore të Kosovës
- D) në Maqedoni

427. Emri i Ferizajt në gjuhën serbe është

- A) Uroševac
- B) Kosovo Polje
- C) Orahovac
- D) Vitimirica

428. Pjesa më e madhe e katundeve arbëreshe në Itali ndodhet

- A) në provincën e Kozencës
- B) në provincën e Krotones
- C) në provincën e Potencës
- D) në provincën e Palermos

429. Në cilin shtet përfshihet Çamëria?

- A) Greqi
- B) Shqipëri
- C) Maqedoni
- D) Mal te Zi

430. Rusia është prodhuesi i parë i naftës në Evropë, ndërsa prodhuesi i dytë është

- A) Romania
- B) Norvegjia
- C) Italia
- D) Izlanda

431. Bjeshkët e Nëmura ndodhen

- A) në Shqipërinë veriore
- B) në Shqipërinë qendrore
- C) në Shqipërië lindore
- D) në Shqipërinë Jugore

432. Goranët janë

- A) popullsi sllavofone e besimit islam e Kosovës dhe Maqedonisë
- B) shqiptarë ortodoksë të Kosovës dhe Maqedonisë
- C) turq të sllavizuar të Kosovës dhe Maqedonisë
- D) popullsi autoktone e Kosovës dhe Maqedonisë që flet një gjuhë neolatine

433. Në Itali ka shumë pakica gjuhësore jo autoktone. Cila është ajo e shpërnadrë në më shumë rajone të vendit?

- A) Arbëreshët
- B) Kroatët
- C) Gjermanët
- D) Oçitanët

434. Pakica etnike më kryesore në Shqipëri janë

- A) grekët
- B) vlllehët
- A) turqit
- B) romët

435. Pas Po-së, lumi i dytë i Italisë për nga gjatësia është

- A) Adixhe-ja
- B) Tiberi
- C) Arno-ja
- D) Volturno-ja

436. Kryeqyteti i Lituanisë është

- A) Vilnius-i
- B) Riga
- C) Tbilis-i
- D) Tallin-i

437. Republika Srpska është pjesë përbërëse e

- A) Bosnjë-Hercegovinës
- B) Kroacisë
- C) Serbisë
- D) Malit të Zi

438. Ishulli i Sazanit ndodhet

- A) në Gjirin e Vlorës
- B) përpara Durrësit
- C) në jug të Korfuzit
- D) në gjirin e Drinit

439. Mali më i lartë i Shqipërisë është

- A) Korabi
- B) Tomori
- C) Jezerca
- D) Ostrovica

440. Kur hyri në fuqi Kushtetuta italiane?

- A) Më 1 janar 1949
- B) Më 1 janar 1946

- C) Më 28 shkurt 1948
- D) Më 1 korrik 1949

442. Apolitë qohen

- A) personat që nuk kanë asnjë shtetësi
- B) imigratët në vendin pritës
- C) personat e gjykuara në mungesë
- D) personat që kanë dy a më shumë shtetësi

443. Në Itali, sa është mosha minimale e duhur që të mund të zgjidhesh President i Republikës?

- A) 50 vjeç
- B) 45 vjeç
- C) 70 vjeç
- D) 55 vjeç

444. Në Itali gratë e fituan të drejtën e votës më

- A) 1946
- B) 1920
- C) 1952
- D) 1949

445. Presidenti i Republikës Italiane zgjidhet për

- A) 7 vjet
- B) 5 vjet
- C) 4 vjet
- D) 9 vjet

446. Kushtetuta e tanishme e Shqipërisë hyri në fuqi

- A) më 1998
- B) më 1992
- C) më 1994
- D) më 1997

447. Si zgjidhet Presidenti i Republikës i Shqipërisë?

- A) E zgjedh Parlamenti, me shumicë prej tri pestave të anëtarëve të tij
- B) Zgjidhet drejpërdrejt nga populli
- C) E zgjedh Parlamenti, me shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të tij
- D) E zgjedh asambleja e kryetarëve të qarqeve mes kandidatëve të propozuar nga Parlamenti

448. Presidenti i Republikës i Shqipërisë zgjidhet për

- A) 5 vjet
- B) 7 vjet
- C) 4 vjet
- D) 9 vjet

449. Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga

- A) 140 deputetë
- B) 160 deputetë
- C) 125 deputetë
- D) 150 deputetë

450. Duke përfshirë senatorë dhe deputetë, anëtarët e Parlamentit italian janë

- A) 915
- B) 630
- C) 315
- D) 725

451. Cili nga rajonet italiane të mëposhtme është me statut të veçantë?

- A) Sardenja
- B) Kalabria
- C) Lombardia
- D) Toskana

452. Në Itali, kush e zëvendëson Presidentin e Republikës, në rast se ai është i penguar?

- A) Kryetari i Senatit
- B) Kryetari i Dhomës së Deputetëve
- C) Kryeministri
- D) Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

453. Në Itali, rendi juridik

- A) është autonom dhe i pavarur nga çdo pushtet tjetër
- B) varet nga Ministria e drejtësisë
- C) varet nga Parlamenti
- D) varet nga Qeveria

454. Në Itali, Gjykata e Llogarive është organ:

- A) kontrollues
- B) administrativ
- C) ligjvënës
- D) gjykues

455. Me cilin organ të Shtetit shqiptar mund të krahasohet organi italian i quajtur “Gjykatë e Llogarive”?

- A) Me Kontrollin e Lartë të Shtetit
- B) Me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
- C) Me Gjykatën e Lartë
- D) Me Këshillin e Lartë të Drejtësisë

456. Në Itali, Kryeministri

- A) emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të partisë ose koalicionit që ka shumicën e vendeve në Parlament
- B) zgjidhet nga qytetarët që e mbushën moshën 25 vjeç

- C) zgjidhet me votim nga dy Dhomat e Parlamentit, nga një listë e propozuar nga partia ose koalicioni që ka shumicën e vendeve
- D) emërohet kryetarët e dy degëve të Parlamentit

457. Në Shqipëri, Kryeministri

- A) emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të partisë ose koalicionit që ka shumicën e vendeve në Kuvend
- B) zgjidhet nga Kuvendi, nga një listë e propozuar nga partia ose koalicioni që ka shumicën e vendeve
- C) zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët që e mbushën moshën madhore
- D) emërohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryetarit të Kuvendit

458. Përpara se të hynte në fuqi ligji Bosi-Fini, imigracionin në Itali e rregullonte

- A) ligji Turko-Napolitano
- B) ligji Martelli
- C) ligji Amato -Napolitano
- D) ligji Gava

459. Sipas Kanunit të Lek Dukagjinit, gjaku mund të pajtohet

- A) me ndërmjetësim të miqve të familjes së të vrarit ose të famullitarit
- B) me ndërmjetësim të kreut të bajrakut ku u krye vrasja
- C) me ndërmjetësim të kreut të fshatit të vrasësit
- D) me ndërhyrje të gjykatës së rrethit

460. Në cilën rajon të Italisë ekzistonte një e drejtë zakonore që ngjan me Kanunet e Shqipërisë?

- A) Sardenjë
- B) Marke
- C) Sicili
- D) Valle d' Aosta

461. Sipas Kanunit të Lek Dukagjinit vajza

- A) nuk e ka drejtën për të zgjedhur të fejuarin e vetë
- B) mund ta zgjedhë të fejuarin e vetë, por i duhet pëlqimi i babajt ose vëllajt
- C) mund ta zgjedhë lirisht të fejuarin e vetë
- D) nuk mund ta zgjedhë të fejuarin e vetë, por duhet pëlqimi i saj për të zgjedhurin

462. Sipas Kanunit të Lek Dukagjinit, kryqi te dera e shtëpisë së të vrarit

- A) tregon se gjaku është pajtuar
- B) tregon se i vrari është në shtëpi
- C) tregon se kanë ndërhyrë ndërmjetësuesit (shkuesit)
- D) tregon se pala e fyer nuk e ka pranuar pajtimin e gjakut

463. Kur themi “rend dorik”, “rend korintik” dhe “rend jonik” e kemi fjalën për

- A) stile arkitektonike klasike
- B) sisteme shoqërore të Helladës së lashtë
- C) sisteme politike të Helladës së lashtë

D) sisteme juridike të Helladës së lashtë

464. Koloseu mbase është monumeti romak më i njohur në botë. Ndërtimin e tij e nisi

- A) Perandori Vespazian, mes viteve 70-72 pas.Krishtit
- B) Perandori Tito, në vitin 80 pas Krishtit
- C) Oktaviani, më 27 para Krishtit
- D) Perandori Trajan më 106 pas Krishtit

465. Veçori dalluese e arkitekturës gotike është:

- A) harku i mprehtë
- B) harku trevingujsh
- C) mozaikët
- D) qemeri në trajtë pavijoni

466. Përpara se të tregonte kishat e para të krishtera, fjala *bazilikë* tregonte godina romake që përdroreshin

- A) si seli gjykatash dhe qendra biznesi
- B) për qëllime fetare
- C) si tregje
- D) si strehë për më të varfërit

467. Kupola e mrekullueshme Katedralit të Firenxes është njëra nga kryeveprat e Rilindjes Italiane. Autori i saj është

- A) Filipo Brunelleski
- B) Mikelanxhelo Buonarroti
- C) Xhorxho Vazari (Giorgio Vasari)
- D) Xhoto-ja (Giotto)

468. Më 1992, Burtinti u shpall nga UNESCO-ja pasuri kulturore e njerëzimit. Si e kishte emrin qyteti në lashtësi?

- A) Buthrotum
- B) Aulon
- C) Orikum
- D) Foinike

469. Në terminologjinë artistike, fjala *afresk* tregon:

- A) një teknikë të veçantë pikturë mbi mur
- B) pikturën mbi dru
- C) një teknikë mozaiku
- D) një tablo të madhe mbi pëlhurë

470. Nismëtari i lëvizjes së pikturës të njohur si *Kubizëm* është

- A) Pablo Pikaso-ja
- B) Salvator Dalì-u
- C) Amedeo Modiljani
- D) Renato Gutuzo-ja

471. I lindur në Ishmi më 1918, piktori i madh shqiptar Ibrahim Kodra vdiq më 7 shkurt 2006 në

- A) Milano
- B) Shkodër
- C) Romë
- D) Androdoko

472. Lindja e Venusit është pa tjetër njëra nga arritjet më të larta të pikturës italiane të Rilindjes.

Autori i sa është

- A) Sandro Botiçelli
- B) Rafaello Sanxio
- C) Leonardo da Vinçi
- D) Ticiano Veçellio

473. Cila nga qytetet shqiptare të mëposhtme u shpall nga UNESCO-ja pasuri kulturore e njerëzimit më 2005?

- A) Gjirokastra
- B) Berati
- C) Korça
- D) Shkodra

474. Vepra e famshme e Mikelanxhelos *Pietà* është

- A) skulpturë
- B) tablo
- C) basoreliev
- D) qeramikë

475. Përveç që për cilësitë artistike të veprës së tij, njëri nga ikonografët shqiptarë të mëposhtëm njihet për nuancën e veçantë të së kuqes që përdorte. Cili?

- A) Onufri
- B) Mihal Anagnosti
- C) Johan Çetiri
- D) Kostandin Jeromonaku

476. Shtyllnaja e Sheshit Shën Pjetër, në Romë është njëri nga simbolet e riorganizimit urbanistik të qytetit në shek. XVI. Cilit stil i përket?

- A) Barokut
- B) Neoklasicizmit
- C) Romanikut
- D) Rokoko-së

477. Cila nga veprat artistike të mëposhtme nuk është skulpturë e Odhise Paskalit?

- A) Vajzë nga Shkodra
- B) I urituri
- C) Portret fëmije
- D) Onufri

478. Renato Gutuzo-jo (Guttuso) është

- A) një piktor i famshëm italian bashkëkohor
- B) një stilist
- C) një arkitekt i Rilindjes italiane
- D) një violinist i famshëm i fillimit të shek. XX

479. Muranat janë

- A) grumbuj gurë në vendin ku u vra ose u varros një njeri
- B) varre ilire të Dardanisë
- C) godina fetare pararomake të Dalmacisë
- D) banesa tipike shqiptare të shek. XIII

480. Piktori amerikan Endi Uarol (Andy Warhol) është njëri nga përfaqësuesit më të rëndësishëm rrymës artistike të shëk. XX të quajtur

- A) Pop-art
- B) Niu Dada (New Dada)
- C) Metafizikë
- D) Futurizëm

481. Ku e ka zanafillën stili arkitektonik gotik ?

- A) Në Francë
- B) Në Gjermani
- C) Në Katalonjë
- D) Në Portugali

482. Kompozitorët italianë Tomazo Albinoni, Antonio Vivaldi dhe Alesandro Skarlatti ishin bashkohës të

- A) Johan Sebastian Bah-ut
- B) Klaudio Monteverdi- t
- C) Nikolò Paganini-t
- D) Rihard Vagner-it

483. Fryderyk Shopen-i (Chopin) lindi më 1810 në

- A) Poloni
- B) Gjermani
- C) Çeki
- D) Hungari

484. Autori i operës “Cavalleria Rusticana” është

- A) Pietro Maskanji
- B) Xhoakini Rosini
- C) Xhakomo Bellini
- D) Alesandro Skarlatti

485. Kori i famshëm “Va’ pensiero” përfshihet në operën e Xhuzepe Verdi-t

- A) Nabucco
- B) I Lombardi alla prima crociata
- C) Aida
- D) Il trovatore

486. Cila nga operat e mëposhtme nuk është e Xhoakino Rosinit?

- A) La Traviata
- B) Otello
- C) Cenerentola
- D) La gazza ladra

487. Vendlindja e Volfang Amadeus Mozartit është

- A) Salzburgu
- B) Vjena
- C) Insbruku
- D) Mynihu

488. “Roma città aperta” (1945) mbase është njëri nga filmat më të përmendur të kinematografisë italiane dhe patjetër njëra nga kryeveprat e neorealizmit. Regjisori i tij është

- A) Roberto Rosellini
- B) Federico Fellini
- C) Vittorio De Sica
- D) Mikelanxhelo Antonioni

489. Cili ishte partneri me të cilin komiku i madh italian Totò xhiroi shumë filma nga të tijtë, të drejtuar kryesisht nga Kamillo Mastrocinque?

- A) Pepino De Filippo
- B) Karlo Krokolo (Croccolo)
- C) Luixhi De Filippo
- D) Nino Taranto

490. Cili nga filmat e Roberto Beninjit fitoi Çmimin Oskar më 1999 si film u huaj më i mirë?

- A) La vita è bella
- B) Johnny Stecchino
- C) Pinocchio
- D) La tigre e la neve

491. Protagonist i filmit të Lukino Viskontit “Il Gattopardo” ishte aktori amerikan Burt Lancaster, ndërsa protagoniste një aktore e re e lindur në Tunizi. Cila?

- A) Klaudia Kardinale
- B) Antonella Lualdi
- C) Sandra Milo
- D) Silvana Mangano

492. Rolin e protagonistes në filmin e famshëm “Vacanze Romane” e luante

- A) Odri (Audrey) Hepburn-i

- B) Greis (Grace) Kelli
- C) Sofia Loren-i
- D) Brizhit Bardot-i

493. Cili nga grupet muzikore të meposhtme ishte kundërshtari historik i Bitëls-ve (Beatles)

- A) Rolling Stons-it
- B) Nirvana
- C) Kuiuin-ët (Queen)
- D) Vanilla Fadxi-ët (Vanilla Fudge)

494. “Lettere al vento” (2002) është njëri nga filmat më të vlerësuar të një regjisorit shqiptar të mërguar në Itali. Si e ka emrin ai?

- A) Edmond Budina
- B) Valton Jakupi
- C) Mark Topallaj
- D) Ilir Butka

495. Seria filmike (1952-1965) me protagonistë priftin Dom Kamillo dhe kryebashkiakun komunist Pepone, frymëzohet nga seria e romaneve të Xhovani Guareskit. Cilët aktorë i luanin përkatësisht rolet e dy protagonistëve?

- A) Fernandel-i dhe Xhino Çervi
- B) Ubaldo Laj dhe Xhino Çervi
- C) Fernandel-i dhe Aldo Fabrici
- D) Alberto Lupo-ja dhe Tino Buacelli (Buazzelli)

496. Autori i teksteve të këngëve më të suksesshme të Luçio Batisti-t ishte

- A) Mogol-i
- B) SerxhoBardoti
- C) Toni Renis
- D) Pieranxhelo Bertoli

497. Aktori shqiptar Bekim Fehmiu arriti suksesin në Itali duke luajtur rolin e

- A) Uliksit në serinë televizive të frymëzuar nga Odisea e Homerit
- B) Kardinal Borromeo-s, në serinë televizive të frymëzuar nga “*I promessi sposi*” të Manxonit
- C) Sandokanit, në serinë televizive të frymëzuar nga romanet e Salgari-t
- D) Ben Hur-it në serinë filmike të frymëzuar nga romanet e Ullas-it (Wallace)

498. Regjisorin e filmit “Ladri di biciclette”, që mbahet të jetë njëri nga kryeveprat e neorealizmit italian është

- A) Vittorio De Sica
- B) Franko Rozi
- C) Pietro Xhermi (Germi)
- D) Renato Kastellani

499. Njëra nga skenat më të famshme të kinematografisë botërore është ajo e një filmi të Federiko Fellini-t, kur Anita Ekberg-u hyn e laget në Shatërvanin e Trevit, në Romë. Për cilin film e kemi fjalën?

- A) La dolce vita
- B) 8 e 1/2
- C) Roma
- D) Luci del varietà

500. Në filmit italo-francez të frymëzuar nga romani i Ismail Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” rolin e protagonistëve e luanin

- A) Mishel Pikoli-u (Michel Piccoli) dhe Marçello Mastrojanni
- B) Mishel Pikoli-u (Michel Piccoli) dhe Alberto Sordi
- C) Alen Delon-i dhe Marçello Mastrojani
- D) Zherard Dëpadjë-a (Gerard Depardieu) dhe Mishel Pikoli-u (Michel Piccoli)